

Manual për Sistemin e Gjurmimit në nivel ofruesi



Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC




swisscontact

MANUAL PËR SISTEMIN E GJURMIMIT NË NIVEL OFRUESI¹

TABELA E LËNDËS

KAPITULLI I - STUDIMET GJURMUESE NË SHIKIM TË PARË	5
1.1. Objektivat dhe lexuesit e mundshëm të këtij manuali	5
1.2. Çfarë është studimi gjurmues?	6
1.3. Studimet gjurmuese në nivel ofruesi (fokus i këtij manuali)	8
1.4. Koha për kryerjen e studimeve gjurmuese dhe popullsia e synuar	10
1.5. Madhësia e kampionit të anketës	11
1.6. Realizueshmëria e studimit gjurmues	11
1.7. Objektivat kryesore të një studimi gjurmues	12
1.8. Nevojat e palëve të interesuara	14
1.9. Organizimi dhe menaxhimi i studimeve gjurmuese	14
1.10. Hapat bazë në një studim gjurmues	15
1.11. Trajnimi	16
1.12. Kërkesat minimale për studimet gjurmuese	16
KAPITULLI 2 – OBJEKTIVAT KRYESORE TË STUDIMEVE GJURMUESE	18
2.1. Lidhjet midis arsimit dhe punësimit	18
2.2. Relevanca e programit arsimor	18
2.3. Vlerësimi i rezultateve në sigurimin e cilësisë	20
2.4. Orientimi i karrierës dhe marketingu institucional	20
2.5. Informacioni për aktorë të ndryshëm	21
2.6. Rrjetet e ish-nxënësve (alumni)	21
KAPITULLI 3 – HARTIMI I STUDIMIT GJURMUES	22
3.1. Cikli i hartimit të studimit gjurmues	22
3.2. Popullsia e synuar	22
3.3. Koha pas diplomimit	23
3.4. Metodot për mbledhjen e të dhënave	23
3.5. Studimi i natyrës cross-sectional kundrejt studimit me të dhënat panel	24
3.6. Studimet e rregullta gjurmuese	25
3.7. Kërkesat për studimet gjurmuese në nivel ofruesi	25
3.8. Analiza e të dhënave	26
3.9. Koha për kryerjen e studimit dhe detyrat kryesore gjatë studimit	26
KAPITULLI 4 - ZHVILLIMI I PYETËSORIT	28
4.1. Pyetësi i standardizuar	28
4.2. Përshtatja e pyetësit tip	28
4.3. Gjatësia e pyetësit	29
4.4. Pyetje të hapura	29

¹ Përgatitur nga Aftësi për Punë. Përshtatur nga Schomburg, H., 2016. Kryerja e studimeve të gjurmimit: Udhëzues për parashikimin dhe përputhjen e aftësive. Torino: ETF, CEDEFOP and ILO.

4.5. Pyetje të mbyllura	30
4.6. Ndryshoret, kodet dhe vlerat	30
4.7. Shkalla e matjes.....	30
4.8. Pyetje në shkallën kategorike ose nominale	31
4.9. Pyetje të hapura	31
4.10. Përgjigje të shumëfishta	32
4.11. Përgjigjet ordinale (numërore)	32
4.12. Niveli metrik i matjes.....	34
4.13. Rregullat për formulimin e pyetjeve.....	34
4.14. Sekuenca e pyetjeve.....	34
4.15. Letra shoqëruese.....	35
4.16. Pilotimi	35
KAPITULLI 5 – MODULET E PYETËSORIT PËR NJË STUDIM GJURMUES	37
5.1. Pyetësi gjurmues në AFP	37
KAPITULLI 6. PËRGATITJA E FAZËS PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE.....	41
6.1. Menaxhimi dhe organizimi	41
6.2. Para fillimit të studimit	41
6.3. Baza e të dhënave për adresat	41
6.4. Faqja e internetit të studimit gjurmues.....	42
6.5. Fletëpalosje me informacion për studimin gjurmues.....	43
6.6. Lista e kontrollit për grumbullimin e të dhënave	43
KAPITULLI 7. AKTIVITETET GJATË FAZËS SË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE	45
7.1. Kontrolli i pyetësorëve të kthyer	45
7.2. Rilajmërimet për kujtesë dhe shërbimi mbështetës (<i>helpdesk</i>)	46
7.3. Trajnimi i stafit të studimit gjurmues	46
KAPITULLI 8. ANALIZA E TË DHËNAVE	47
8.1. Programet (<i>software</i>) për analizën e të dhënave.....	47
8.2 Kodimi	47
8.3. Rregullat për emrat e pyetjeve dhe ndryshoreve.....	48
8.4. Analiza e thjeshtë e të dhënave: frekuencat	48
8.5. Analiza e mëtejshme statistikore	48
KAPITULLI 9. PREZANTIMI I REZULTATEVE	50
9.1. Sfidat kryesore në lidhje me interpretimin.....	50
9.2. Raporti për metodën	51
9.3. Raporti mbi rezultatet	52
9.5. Interpretimi i rezultateve dhe konkluzioneve praktike	53
9.6. Keqinterpretimi i rezultateve	56
9.7. Aktivitetet ndërgjegjësuese.....	57
KAPITULLI 10. VETË-VLERËSIMI I CILËSISË SË STUDIMIT	58
Aneks 1. Model pyetësor gjurmimi.....	60

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Anketat me të diplomuarit nga programet arsimore shpesh quhen studime gjurmuese ose anketa të të diplomuarve. Ky manual është përshtatur për t'iu shërbyer koordinatoreve të gjurmimit pranë Njërive të Zhvillimit² në institucionet e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri dhe të gjithë kapitujt kanë lidhje me këtë grup përdoruesish. Ai bazohet në përvojën e mbledhur gjatë periudhës 2017-2019 nga shtatë ofrues të AFP-së, të cilët kanë kryer studime gjurmuese për tre breza të diplomuarish.

Manuali bën një prezantim hap pas hapi të gamës së gjerë të qasjeve të ndryshme të studimeve gjurmuese dhe del me propozime praktike për pikëpyetjet kryesore në lidhje me mënyrën e hartimit të një studimi gjurmues:

- Cilët të diplomuar duhet të përfshihen?
- Në çfarë kohe pas diplomimit duhet të kryhet studimi gjurmues?
- Si mund të kontaktohen të diplomuarit?
- Çfarë mund të bëhet nëse nuk ka adresa të vlefshme?
- Cilat metoda duhet të përdoren për mbledhjen e të dhënave?
- Cilat janë kërkesat dhe procedurat e analizës së të dhënave?
- Si mund të evitohen keqinterpretimet e gjetjeve?

Manuali trajton problemet kyçe që kanë të bëjnë me përdorshmërinë e studimeve gjurmuese: shkallën e ulët të përgjigjeve dhe koston e lartë. Ai ofron zgjidhje praktike për arritjen e niveleve të larta të përgjigjes, duke i mbajtur kostot në nivele të ulëta. Të dhënat nga studimet gjurmuese në nivel ofruesi, të cilat zakonisht përpiqen të marrin përgjigje të vazhdueshme nga të gjithë të diplomuarit e një shkolle AFP rreth një deri në dy vjet pas diplomimit, bëjnë të mundur lidhjen e situatës së punësimit dhe të punës së të diplomuarve me përvojat e tyre arsimore në nivel programi studimi / formimi, *i cili është edhe objektivi i projektit 'Aftësi për Punë' (S4J)*.

Nëse studimet gjurmuese në nivel ofruesi kanë cilësinë e duhur, atëherë të dhënat mund të përdoren edhe për sistemin kombëtar të monitorimit ose për kryerjen e vlerësimeve në kontekstin e projekteve/programeve të reformës arsimore. Megjithëse specifikat kombëtare dhe specifikat lëndore / sektoriale janë relevante për çdo studim gjurmues, praktikatat e mira ekzistuese ndërkombëtare janë të dobishme për të udhëzuar fillestarët dhe projektet më me përvojë sa i takon studimeve gjurmuese. Pyetësi përdor pyetje dhe përgjigje të standardizuara, tashmë të testuara dhe të përdorura në shumë anketa, në mënyrë që të sigurohet cilësia e matjes (vlefshmëria dhe besueshmëria) dhe të përmbushen parakushtet e rëndësishme për krahasueshmërinë e rezultateve të studimit. Manuali thekson nevojën e raportimit për metodologjinë e përdorur për të mbështetur kredibilitetin e çdo studimi gjurmues.

² Në Ligjin e AFP-së (15/2017) parashikohet ngritja e Njërive të Zhvillimit (NJZH) tek çdo ofrues i AFP-së në Shqipëri. Ndër shtatë funksionet e NJZH-së është edhe zbatimi i studimeve gjurmuese në nivel ofruesi, duke përfshirë dhe sigurimin e të dhënave për organet përkatëse kombëtare që kryejnë studime gjurmuese në rang kombëtar.

KAPITULLI I - STUDIMET GJURMUESE NË SHIKIM TË PARË

Kapitulli I shpjegon konceptet kryesore të studimeve gjurmuese dhe përmbledh rekomandimet mbi studimet gjurmuese të ofruesve, duke u bazuar në perceptimin e përbashkët që:

- Informacioni për punëkërkimin, kushtet e punësimit dhe të punës merren si sinjal i mundësive në tregun e punës për të diplomuarit nga programe të ndryshme studimi (drejtime, profile, kurse);
- Mendimet për zhvillimin e kurrikulës dhe aspekte të tjera për përmirësimin e kushteve të studimit dhe ofertës së trajnimit është një aspekt i rëndësishëm i studimeve gjurmuese të kryera nga ofruesit;
- Studimet e vazhdueshme gjurmuese duhet të përfshijnë të gjithë të diplomuarit nga një brez të diplomuarish (i njëjti vit i diplomimit), të cilët duhet të anketohen rreth një deri dy vjet pas diplomimit.

Ky kapitull është veçanërisht i rëndësishëm për drejtorët, përgjegjësit e Njërive të Zhvillimit, drejtuesit e departamenteve të institucioneve të AFP-së. Nga studimet gjurmuese, ata mund të informohen në lidhje me pikat e tyre të dobëta e të forta, të nevojshme për të marrë vendime kuptimplota për hartimin e programeve studimore dhe për të ofruar zgjidhje praktike për sfidat e identifikuar.

1.1. Objektivat dhe lexuesit e mundshëm të këtij manuali

1.1.1. Relevanca e arsimit / formimit

Ky manual ka për qëllim të kontribuojë në përmirësimin e ofertës së AFP-së dhe qeverisjes së ofruesve të AFP-së, duke kryer studime gjurmuese për të diplomuarit. Këto studime duhet të bëjnë të mundur edhe analizën e ndikimeve të programeve dhe kushteve të studimit në institucionet e AFP-së. Objektivi kryesor është identifikimi i relevancës së arsimit / formimit për kalimin drejt një vendi pune dhe / ose karriere të mëtijshme profesionale në vitet e para pas diplomimit.

Shumë vende janë duke u përballur me kërkesën në rritje për ngritjen e sistemit të studimeve gjurmuese për shkak të kërkesave për riakreditime dhe menaxhimin e cilësisë. Institucionet arsimore shpesh detyrohen me ligj për të kryer studime të vazhdueshme gjurmuese dhe, përveç kësaj edhe kërkesa nga agjencitë e donatorëve të ndryshëm ose palët e interesuara për të mbledhur dëshmi empirike në lidhje me relevancën e arsimit / formimit po rritet.

Në kontekstin shqiptar, ndryshimet e kohëve të fundit në kuadrin politik dhe legjislativ kanë nxitur po ashtu kërkesën në rritje për të kaluar nga praktikatat *ad hoc* të gjurmimit të të diplomuarve tek praktikatat sistematike. Në nivel politikash, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) dhe Plani i Veprimit 2014-2020 përfshin 'krijimin e një sistemi gjurmues me ndjeshmëri gjinore për të diplomuarit e AFP-së' nën shtyllën e saj të katërt strategjike në

kuadrin e forcimit të qeverisjes së tregut të punës dhe të sistemeve të kualifikimit (prioriteti strategjik D/D3.2). Në nivel legjislativ, Neni 9/2 i Ligjit nr. 15/2017 'Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë' institucionalizon gjurmimin e të diplomuarve në nivel kombëtar dhe ngarkon Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për kryerjen e studimeve gjurmuese në AFP. Përveç kësaj, sipas nenit 15 të ligjit, Njësitë e Zhvillimit në shkollat e AFP-së janë përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave në nivel ofruesi.

1.1.2. Lexuesit e mundshëm

Në këtë manual, lexuesit do të gjejnë udhëzime të hollësishme në lidhje me mënyrën e përgatitjes së një studimi gjurmues, zhvillimin e pyetësorit dhe kryerjen e analizës së të dhënave, edhe pa qenë ekspertë për metodologjinë e anketimit.

Manuali iu tregon se si të:

- Planifikoni dhe përgatisni një studim gjurmues
- Formuloni objektivat dhe pyetjet e studimit
- Zhvilloni pyetësorin
- Mblidhni dhe përditësoni adresat e ish-nxënësve
- Organizoni mbledhjen e të dhënave
- Analizoni të dhënat dhe të interpretoni rezultatet

Ai synon personat nga ofruesit e AFP-së të cilët do të fillojnë të përdorin sistemin gjurmues në institucionin e tyre (studimet gjurmuese tek ofruesi). Gjithashtu, manuali synon edhe kategori të tjera të përdoruesve, të tilla si:

- Politikëbërësit dhe vendimmarrësit (në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal në të gjithë sektorët) në kërkim të informacionit dhe të dhënave për të informuar procesin e vendimmarrjes;
- Qendrat kërkimore dhe rrjetet e ekspertëve që kryejnë studime gjurmuese për klientët; dhe
- Shoqatat dhe rrjetet e interesuara për të dhënat e siguruar nga studimet gjurmuese (p.sh. këshillat sektoriale të aftësive, shoqatat e industrisë).

1.2. Çfarë është studimi gjurmues?

1.2.1. Përkufizim

Studimi gjurmues është një anketë e standardizuar e të diplomuarve nga institucionet e arsimit / formimit, që zhvillohet pas diplomimit / certifikimit të tyre. Temat e një studimi gjurmues mund të jenë të shumëfisha, por temat e përbashkëta përfshijnë pyetje në lidhje me ecurinë gjatë studimit, kalimin në punë, hyrjen në punë, karrierën, përdorimin e kompetencave të mësuara, profesionin aktual dhe lidhjet me institucionet arsimore. Si i tillë, për anketat e të diplomuarve përdoren terma të ndryshme:

- Anketa/ studimi i të diplomuarve
- Anketa / studimi i ish-nxënësve
- Gjurmimi i (karrierës së) të diplomuarve
- Anketa / studimi pasues
- Anketa/ studimi i tranzicionit
- Anketa/ studimi gjurmues

Anketat e standardizuara zakonisht bëhen me anë të një pyetësoi në letër ose, së fundmi, me anë të pyetësorëve në internet. **Fokusi i këtij manuali do të jetë që të udhëzojë përdoruesit në lidhje me përdorimin e studimeve gjurmuese në internet.**

1.2.2. Studimet gjurmuese tradicionale në rang kombëtar

Lloji tradicional i studimit gjurmues karakterizohet nga qasja e tij e centralizuar. Normalisht, një institut studimor e kryen anketën sipas nevojave të një ministrie të linjës (zakonisht ministrive përgjegjëse për arsimin ose punën) dhe të Shërbimeve Kombëtare të Punësimit. Ministrinë e linjës sigurojnë adresat e të diplomuarve, por nuk luajnë rol aktiv në procesin e studimit, përveç ofrimit të ndihmës teknike. Në disa raste, ata mund të dërgojnë ftesat për pjesëmarrje.

Në disa vende europiane (Francë, Gjermani, Itali, Norvegji, Zvicër) këto anketa përfaqësuese janë kryer në arsimin e lartë për rreth 30 vjet. Objektivi kryesor është informimi i ministrive dhe organeve të tjera qendrore në lidhje me suksesin e të diplomuarve në tregun e punës. Këto studime përdorin një pyetësor kombëtar (nuk bëhen përshtatje për institucione të veçanta) dhe nuk japin rezultate për institucione të veçanta (përveç Zvicrës). Megjithatë, ato mund të jenë të dobishme për analizën e mospërputhjes së aftësive në nivel kombëtar në kombinim me informacionin nga burimet e tjera të të dhënave.

Shembuj të studimeve gjurmuese në AFP në rang kombëtar

Armeni

Studimi gjurmues i të diplomuarve më të fundit nga institucionet e arsimit profesional në Kotayk dhe Ararat Marzes të Armenisë (ETF dhe CRRC, 2012). Përfshirja e të diplomuarve të sistemit të arsimit profesional në tregun e punës për vitin 2010-2011 (Manukyan, 2012).

Gjermani

Anketat e BIBB-it për të diplomuarit e shkollës: 'BIBB ka një traditë të gjatë sa i takon anketimeve. Ai ndërmer dhe realizon mbledhjen e të dhënave individuale dhe në nivel firme për pozicionet kryesore dhe kalimin nga sistemi i arsimit në tregun e punës.' <http://www.bibb.de/en/14512.php>

Hollandë

Studime të vazhdueshme të të diplomuarve të shkollave në Holandë: 'Anketat e të diplomuarve të shkollës janë projektuar për të funksionuar si një instrument monitorues për kalimin nga shkolla në punë, duke mbuluar të gjithë sistemin arsimor holandez. Statistikat e nxjerra nga këto anketa përmbajnë informacion mbi rezultatet në tregun e punës, kompetencat dhe aktivitetet pasuese studimore.'

1.3. Studimet gjurmuese në nivel ofruesi (fokus i këtij manuali)

Gjatë 15 viteve të fundit është shfaqur një lloj i ri studimi gjurmues, *studimi gjurmues në nivel ofruesi* dhe në këtë kuadër një numër gjithnjë e më i madh i institucioneve të arsimit dhe formimit kanë filluar të kryejnë studime gjurmuese, ndonjëherë në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera arsimore (qasja në rrjet).

1.3.1. Objektivat

Studimet gjurmuese të ofruesve mund të kenë shumë objektiva që lidhen ose me marrjen e mendimeve për përmirësimin e programit të studimit / formimit ose me studimin e marrëdhënieve midis arsimit (ofertës) dhe punës (kërkesës).

Mendimet për zhvillimin e kurrikulës dhe aspekte të tjera të përmirësimit të kushteve dhe ofertës së studimit janë shpesh elementi më i rëndësishëm i studimeve gjurmuese në nivel ofruesi. Informacioni për punëkërkimin, kushtet e punësimit dhe të punës merret si sinjal për mundësitë e të diplomuarve nga programe të ndryshme studimi në tregun e punës.

Me interes të veçantë është lidhja horizontale midis arsimit dhe punës dhe më konkretisht:

- Si lidhen detyrat e të diplomuarve në punë me programin e studimit dhe kompetencat e tyre?
- A i kanë marrë kompetencat e kërkuara?

Marrja e përgjigjeve kuptimplote për këto pyetje kërkon edhe marrjen parasysh të rëndësisë së faktorëve të tjerë përveç arsimit, të cilat mund të shpjegojnë 'rezultatit e punësimit', siç janë aspektet e kontekstit social-biografik (gjinia, rajoni, mosha, përvoja e punës para studimit), sjellja gjatë studimit dhe kushtet e tregut të punës.

Një informacion i tillë mund të përdoret edhe për të informuar nxënësit e mundshëm (dhe prindërit e tyre) dhe mund të jetë i dobishëm për punëkërkimin nga ana e të diplomuarve (orientimi i karrierës). Studimet gjurmuese në nivel ofruesi janë kryesisht relevante për institucionet e veçanta (raportet për ofruesit e veçantë, ndarja e rezultateve sipas nivelit të programit të studimit nëse numri i të diplomuarve është shumë i madh për të bërë të mundur kryerjen e një analize të tillë) dhe në disa vende ato përdoren edhe si një mjet kombëtar për monitorimin e performancës (në Gjermani, Hungari, Rumani).

Shembuj të studimeve gjurmuese në nivel ofruesi

Ky lloj i ri i studimit gjurmues zbatohet në Finlandë, Francë, Gjermani, Hungari, Indonezi, Itali, Hollandë dhe Rumani.

Shembulli 1: Studimi gjurmues i projektit 'Aftësi për Punë'

Në shtator të vitit 2017, projekti 'Aftësi për Punë' (S4J) mbështeti ngritjen e një sistemi gjurmues tek ofruesit, me qëllim evidentimin empirik të rezultateve në tregun e punës të të diplomuarve të AFP dhe analizimin e lidhjes horizontale midis arsimit dhe punës përmes vlerësimit retrospektiv të të diplomuarve. Ky studim gjurmues u fokusua tek të diplomuarit të cilët i kishin përfunduar studimet e tyre në vitin 2016, 2017 dhe 2018 në 6 institucione të synuara të AFP-së dhe në 1 QFP në Shqipëri. Zbatimi i sistemit gjurmues përbëhej nga dy faza: Para-gjurmimi - që kishte për qëllim mbledhjen e të dhënave bazë të të diplomuarve të ardhshëm në lidhje me planet dhe pritshmëritë e tyre subjektive në lidhje me karrierën, karakteristikat social-demografike dhe informacionet e kontaktit, dhe Gjurmimi - që kishte për qëllim raportimin e përvojës së të diplomuarve sa i takon kalimit në tregun e punës një vit pas diplomimit dhe vlerësimin e tyre retrospektiv për shkollën. Për këtë qëllim si mjet për mbledhjen e të dhënave u përdor një pyetësor i strukturuar i cili vetë-administrohet *online* përmes përdorimit të Platformës *Kobo Toolbox*. Vizitoni faqen e projektit në internet këtu: <http://skillsforjobs.al/>

Shembulli 2: Modeli rumun i studimit gjurmues³

Ky studim përfshiu të diplomuarit që përfunduan studimet e tyre në vitin 2005 dhe 2009 në rreth 55 universitete publike dhe private. Gjatë katër fazave të kontaktimit, nga muaji nëntor 2010 deri në muajin mars 2011, secili prej universiteteve i ftoi të diplomuarit e tij që të plotësonin pyetësorin. Një ftesë dhe tre rilajmërimë për kujtesë u dërguan me postë normale dhe me postë elektronike. Plotësimi i pyetësorit përfundoi më 31 mars 2011, me pjesëmarrjen e 39,293 të anketuarve. Gjatë fazës së dytë studimi përfshiu të diplomuarit që kishin përfunduar studimet e tyre në vitin 2006 dhe 2010 në rreth 42 universitete publike dhe private. Ajo u nda në pesë periudha kontaktimi, nga data 2 prill 2012 deri në 30 prill 2012. Një ftesë dhe katër rilajmërimë për kujtesë u dërguan me e-mail. Në këtë fazë u përdorën disa metoda të reja kontaktimi: ftesa të shkurtra në formë mesazhi si edhe një formular vetë-regjistrimi i vënë në dispozicion në faqen e internetit të projektit. Plotësimi i pyetësorit përfundoi në qershor 2012, me pjesëmarrjen e 9,294 të anketuarve.

Shembulli 3: Kongrad: studimet gjurmuese në Serbi, Malin e Zi dhe Bosnjë e Hercegovinë

'Objektivi më i gjerë i projektit të Kongradit është të aftësojë institucionet e arsimit të lartë në Serbi, Malin e Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinë për të kryer anketimin e të diplomuarve në mënyrë të vazhdueshme me qëllim rritjen e ofertave të studimit dhe lehtësimin e proceseve të modernizimit të përhershëm. 'Kongrad pritet të kontribuojë në përmirësimin e proceseve

³ Të Diplomuarit e Universiteteve dhe Tregu i Punës: Studimi rumun gjurmues: <http://www.absolvent-univ.ro>

të vetëvlerësimit institucional duke mbledhur informacion sistematik dhe të besueshëm mbi lidhjet mes ofertave të studimit dhe punësimit pasues të të diplomuarve, si dhe të mundësojë vlerësimin e bazuar në dëshmi të reformave në arsimin e lartë dhe ndryshimeve kurrikulare në dekadën e fundit. Duke marrë parasysh kushtet e mëparshme të studimit dhe karrierën profesionale të të diplomuarve, Kongrad synon të dalë me një perceptim të përgjithshëm të procesit të kalimit nga arsimi i lartë në tregun e punës në kushtet specifike të vendit dhe të bëjë të mundur që IAL-të e vendeve partnere të marrin vendime strategjike të bazuara në dëshmi e të dhëna. Në terma më specifik, Kongrad pritet të çojë drejt zbatimit të një sistemi sistematik për mbledhjen e të dhënave për ish-studentët në IAL-të e vendeve partnere.

Për më shumë informacion, vizitoni: <http://www.congrad.org/project-description>

1.4. Koha për kryerjen e studimeve gjurmuese dhe popullsia e synuar

Shumica e studimeve gjurmuese fokusohen tek vetëm një grup homogjen nxënësish / kursantësh (një 'brez') të cilët i kanë përfunduar studimet e tyre në të njëjtën kohë (një brez ose grup të diplomuarish).

! Studimet e rregullta gjurmuese duhet të përfshijnë vetëm një brez të diplomuarish.

Një element i rëndësishëm për t'u marrë parasysh është koha kur do të kryhet anketa në raport me datën e diplomimit. Sa kohë duhet të kalojë derisa të diplomuarit / të trajnuarit të ftohen të marrin pjesë në studim?

Ka mendime të ndryshme sa i takon kohës më të mirë e më të përshtatshme pas diplomimit për të kryer studimin. Ndërkohë që gjashtë muaj pas diplomimit mund të konsiderohet shumë herët, një argument tjetër do të ishte që studimi gjurmues duhet të kryhet vetëm disa muaj pas diplomimit, sepse kjo siguron informacion të shpejtë dhe kontaktimi i të diplomuarve është më i lehtë. Megjithatë, "anketat për destinacionin e parë" që kryhen rreth gjashtë muaj pas diplomimit (Britani e Madhe dhe Australi) janë jo dhe aq të zakonshme. Shumica e studimeve të rregullta gjurmuese në arsimin e lartë zhvillohen nga një vit deri në tre vjet pas diplomimit (Kosta Rikë, Francë, Gjermani, Hungari, Indonezi, Itali, Zvicër).

Duke patur parasysh objektivat e studimit gjurmues, të dy argumentet mund të mbështeten, por edhe të kritikohen. Nëse duam që rezultatet të na ndihmojnë për përmirësimin e programeve të studimit, atëherë është e nevojshme që shumica e të diplomuarve të kenë arritur të gjejnë punë dhe të kenë një përvojë relevante pune. Nuk ka kuptim që anketa të kryhet shumë herët kur shumica e të diplomuarve janë ende në kërkim të punës së tyre të parë.

! Studimi gjurmues duhet të kryhet 12 muaj pas diplomimit.

1.5. Madhësia e kampionit të anketës

Në anketë duhet të ftohen për të marrë pjesë të gjithë të diplomuarit e një brezi të caktuar. Në përgjithësi, grupi i synuar në studimet gjurmuese të fushave të veçanta lëndore në një institucion të vetëm arsimor është numri i përgjithshëm i të diplomuarve. Qëllimi është të arrihet pjesëmarrja në anketë e pothuajse të gjithë të diplomuarve.

Studimet gjurmuese institucionale duhet të kenë pjesëmarrjen e sa më shumë të diplomuarve nga programet e ndryshme studimore. Jo të gjithë të diplomuarit e ftuar do të marrin pjesë; norma e përgjigjes është zakonisht shumë më poshtë se 100%. Prandaj, në çdo studim gjurmues pjesëmarrësit janë vetëm një kampion i të gjithë të diplomuarve. Nëse institucioni i AFP-së është në kërkim të rezultateve me qëllim përmirësimin e kurrikulave të programit të studimit, ata kanë nevojë të kenë rezultate për programe të ndryshme studimi (drejtime, profile, kurse).

Kampionimi nuk është i nevojshëm, duke patur parasysh faktin që në shumicën e studimeve gjurmuese institucionale numri i të diplomuarve është relativisht i ulët. Studimet gjurmuese institucionale duhet të përfshijnë të gjithë të diplomuarit e një grupi, të cilëve do t'u kërkohet të marrin pjesë në studim.

! Studimet gjurmuese në nivel ofruesi duhet të përfshijnë të gjithë të diplomuarit e një grupi, të cilëve do t'u kërkohet që të marrin pjesë në studim.

1.6. Realizueshmëria e studimit gjurmues

Realizueshmëria e studimeve gjurmuese varet nga dy faktorë kryesorë:

- a) sigurimi i adresave të vlefshme; dhe
- b) gatishmëria e të diplomuarve për të marrë pjesë (shkalla e përgjigjes)

Niveli i ulët i përgjigjes mund të sjellë dyshime rreth anshmërisë potenciale të rezultateve të gjeneruara. Nëse pjesëmarrësit nuk janë përfaqësues të popullsisë së përgjithshme, edhe përdorshmëria e rezultateve është në pikëpyetje. Për të siguruar nivele të larta të pjesëmarrjes, duhet të merren parasysh disa qasje:

- Ndonjëherë është e nevojshme të zhvillohet një fazë para-gjurmuese rreth 4-6 javë para se të diplomuarit të largohen nga institucionet e tyre përkatëse me qëllim përditësimin e informacionit të tyre të kontaktit
- Përdorimi i Facebook-ut dhe i rrjeteve të tjera sociale për të ndihmuar gjatë propagandimit
- Përdorimi i teknikës 'snowball' duke i pyetur të diplomuarit për adresat e miqve që janë diplomuar së bashku me ta
- Përfshirja e shoqatave të ish-nxënësve

- Qasja e punëdhënësve për të siguruar adresat
- Përfshirja e mediave lokale për t'i bërë reklamë studimit gjurmues
- Ofrimi i stimujve për të diplomuarit me qëllim që të marrin pjesë në studimin gjurmues, duke përfshirë lotaritë ku mund të fitohen pajisje elektronike.

Adresat e të diplomuarve të AFP-së bëhen të pavlefshme shumë shpejt pasi ata lëvizin nga një vend në një vend tjetër për punë ose trajnim; sa më e gjatë të jetë perioda pas diplomimit, aq më shumë vihet në dyshim edhe vlefshmëria e adresave.

! Për të siguruar nivele të larta të pjesëmarrjes së të diplomuarve në studimet gjurmuese në nivel ofruesi, duhet të përdoren qasje të ndryshme që variojnë nga kryerja e një faze para-gjurmimi deri tek përdorimi i llogarive të mediave sociale dhe ofrimi i stimujve për pjesëmarrje.

Një faktor kyç për arritjen e një niveli të lartë përgjigjeje është edhe dërgimi i rilajmërimeve për kujtesë. Zakonisht për anketat me postë/në internet dërgohen deri në dy rilajmërimë për kujtesë, që do të thotë se ata që nuk u përgjigjen janë kontaktuar tri herë. Faktorë të tjerë, të cilët mund të kontribuojnë në shkallën e përgjigjes përfshijnë:

- Relevancën e pyetësorit
- Cilësinë dhe organizimin e pyetësorit
- Llojin dhe përmbajtjen e ftesave

1.7. Objektivat kryesore të një studimi gjurmues

1.7.1. Pyetjet/ objektivat kryesore të studimit

Pothuajse të gjitha studimet gjurmuese duhet të japin përgjigje për pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë ndodh me të diplomuarit pas largimit nga institucioni i AFP-së?
- A kanë arritur të gjejnë punësim me pagesë brenda një periudhe të pranueshme kohore?
- A i përdorin aftësitë dhe njohuritë që kanë fituar në institucionin e AFP-së? Nëse jo, cilat janë arsyt?
- Cilat janë aftësitë dhe kompetencat e kërkuara në tregun e punës?

Këto lloje pyetjesh pasqyrojnë dy objektivat kryesore të studimeve gjurmuese:

- **Matjen e punësueshmërisë së të diplomuarve** (informacioni për tregun e punës) duke përfshirë temat kryesore të lidhura me të si:
 - Situata e punësimit
 - Koha e nevojshme për të siguruar punësimin e parë
 - Kohëzgjatja e punëkërkimit
 - Paga / të ardhurat
 - Pozicioni

- Sektori ekonomik
 - Detyrat / përgjegjësitë kryesore në punë
 - Koha e punës
 - Niveli i kënaqshmërisë në punë
 - Përdorimi i kompetencave dhe kompetencat e kërkuara
 - Dobishmëria e programit të studimit / formimit
- **Mbledhjen e mendimeve nga të diplomuarit dhe përmirësimin e programit të studimit (vlerësim retrospektiv)** duke përfshirë temat kryesore të lidhura me të si:
 - Arsimi dhe formimi i mëtejshëm (shtigjet e edukimit)
 - Nevoja për arsim dhe formim të mëtejshëm
 - Vlerësimi i programit të studimit / formimit
 - Pikat e forta dhe pikat e dobëta të programit të studimit / formimit
 - Propozimet për përmirësime

Potenciali i studimeve gjurmuese, në krahasim me statistikën e arsimit apo tregut të punës, qëndron në kombinimin e të dhënave objektive dhe subjektive dhe në fleksibilitetin për të mbuluar temat relevante për institucionet e veçanta të arsimit / formimit. Përmbajtja e studimeve gjurmuese (pyetësori) mund të jetë fleksibël dhe i përshtatur lehtësisht për nevojat specifike të institucioneve të veçanta ose programeve të studimit / formimit. Krahas kriterëve krejtësisht sasiorë që lidhen me suksesin në punë (paga, pozicioni, kushtet e punës) mund të ketë edhe pyetje në lidhje me motivimin individual, kënaqshmërinë dhe arsyetimin. Anketat e të diplomuarve mund të krijojnë një tablo në lidhje me karrierën e gjithsecilit në studim, motivet për zgjedhjen e një programi studimi dhe kalimin drejt punës dhe karrierës në punë.

Vetëvlerësimi i të diplomuarve bën të mundur informimin në lidhje me përdorimin e njohurive të fituara gjatë studimeve, përputhjen me pritshmëritë në punë dhe përshtatshmërinë e punësimit. Të diplomuarit mund të vlerësojnë në mënyrë retrospektive edhe kushtet në programin e tyre të studimit dhe në institucionin e tyre të arsimit / formimit.

Në një studim gjurmues mund të përfshihen një gamë e gjerë e aspekteve të punësimit, punës dhe përvojave të të nxënies të mëparshme, dhe jo vetëm gjetjet e thjeshta përshkuese. Studimet gjurmuese mund të shpjegojnë edhe shkaqet e suksesit profesional dhe të analizojnë ndikimin e tipareve të ndryshme të institucioneve të AFP-së (Figura 2).

Studimet gjurmuese në nivel ofruesi kanë zakonisht dy objektiva kryesore:

- 1. Matjen e treguesve kryesore në tregun e punës të të diplomuarve të AFP (tregues objektivë);**
- 2. Vlerësimin e lidhjes horizontale midis arsimit dhe punës nëpërmjet vlerësimit retrospektiv të të diplomuarve (tregues subjektivë).**

1.8. Nevojat e palëve të interesuara

Megjithëse aktorë të ndryshëm mund të kenë nevojat e tyre specifike në lidhje me informacionin që duhet të mblidhet nga të diplomuarit, përsëri duhet të arrihet në një marrëveshje sa i takon rëndësisë së pyetjeve thelbësore.

Orientimi i karrierës dhe këshillimi i nxënësve janë fusha, të cilat mund të përdorin informacion objektiv mbi vendndodhjen e të diplomuarve. Informacioni për kohën e nevojshme për gjetjen e punës së parë pas diplomimit dhe kushtet e punësimit është i dobishëm për ata persona që janë të interesuar të fillojnë studimet ose për nxënësit aktualë. Edhe personat e angazhuar në zhvillimin e kurrikulave mund të jenë po aq të interesuar për këto të dhëna objektive, por zakonisht ata kërkojnë informacion, që i ndihmon të vendosin se çfarë përmirësimesh duhen bërë. Vlerësimi i kushteve dhe ofertës së studimit nga të diplomuarit, si dhe informacioni në lidhje me përdorimin e kompetencave, shihen shpesh si shumë të dobishme.

Të gjithë aktorët duhet të jenë të interesuar në përfitim të dhënave me cilësi të lartë dhe për këtë arsye, ata duhet të mbështesin dhe të bëjnë përpjekjet e nevojshme. Një marrëveshje e përbashkët për objektivat e studimit gjurmues kërkon besim midis palëve të interesuara në mënyrë që të mos keqpërdoren rezultatet. Meqenëse interpretimi i rezultateve kërkon përdorimin e informacionit kontekstual, siç janë formimi arsimor, motivet e nxënësve dhe situata në tregun rajonal të punës, publikimi i të dhënave të pastra për situatën e punësimit të të diplomuarve mund të përdoret në mënyrë të pasaktë.

1.9. Organizimi dhe menaxhimi i studimeve gjurmuese

Karakteristikat kryesore të studimeve gjurmuese të kryera tek ofruesit janë si më poshtë:

- Stafi i institucionit luan një rol kyç në kryerjen e të gjitha detyrave për realizimin e anketimit
- Stafi i institucionit zakonisht trajnohet për metodologjinë e anketës dhe zhvillimin e instrumenteve
- Pyetësi është relevant për çdo institucion të veçantë
- Të gjithë të diplomuarit (jo kampion) e një viti janë të ftuar të marrin pjesë në studim

Sfidat kryesore lidhen me:

- Krijimin e një baze të dhënash me detajet e kontaktit të adresave të vlefshme të të diplomuarve
- Përdorimin e metodave të përshtatshme për të marrë një shkallë të lartë përgjigjeje
- Analizimin e të dhënave me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve që lidhen me pyetjet e studimit

Studimi gjurmues duhet të ketë një ekip të përbërë nga:

- Koordinator i projektit (ekspert i arsimit, person kontakti - personi përgjegjës për studimet gjurmuese në Njësinë e Zhvillimit)
- Anëtarët e ekipit me përgjegjësitë e mëposhtme: menaxhimin e projektit, TI (kur përdorin pyetësorët në internet), shkrimin e raportit dhe prezantimet, analizën statistikore
- Partnerët e jashtëm (nëse është e nevojshme, punësimi i kontraktuesve të veçantë)

Njësia e Zhvillimit pranë ofruesve të AFP-së është organi përgjegjës për hartimin, planifikimin dhe organizimin e studimeve gjurmuese duke siguruar cilësinë e procesit dhe rezultatin fundor. Detyrat tipike që duhet të kryejnë strukturat drejtuese gjatë zhvillimit të një studimi gjurmues institucional janë si më poshtë:

- Shpërndarja e punës dhe përgjegjësi
- Komunikimi / takimet me ekipin
- Kontrollimi i fluksit të punës
- Programimi

Takimet e rregullta të ekipit për të kontrolluar punën e bërë dhe planifikuar hapat e mëtejshëm është një aspekt shumë i rëndësishëm për të siguruar suksesin e studimit gjurmues. Procesverbalet e këtyre takimeve janë të dobishme dhe duhet të kontrollohen dhe të miratohen zyrtarisht nga anëtarët e ekipit në mbledhjen e radhës.

1.10. Hapat bazë në një studim gjurmues

Në përgjithësi, zbatimi përfshin tre hapat e treguar në figurën e mëposhtme, të cilat janë përshkruar në detaje në këtë udhëzues. Tre hapat bazë të një studimi gjurmues janë si më poshtë:

1. Zhvillimi i konceptit dhe instrumenteve / Përgatitja e të dhënave
2. Mbledhja e të dhënave me rilajmërimë për kujtesë.
3. Analiza e të dhënave dhe shkrimi i raportit: aktivitetet propaganduese; veprimet




Figura 1 Hapat bazë

Ky manual ofron udhëzime, këshilla, rekomandime dhe rregulla për çdo hap të anketës, të cilat do të jenë një ndihmesë e konsiderueshme për kryerjen e anketave me cilësi të lartë.

1.11. Trajnimi

Me qëllim realizimin me sukses dhe sipas standardeve të studimeve gjurmuese tek ofruesit, në secilin institucion duhet të zhvillohen aktivitete për ngritjen e kapaciteteve. Trajnimi duhet të mbulojë të gjitha fazat e studimit gjurmues:

- Koncepti i studimeve gjurmuese në nivel ofruesi (nisja)
- Zhvillimi i pyetësorit
- Përgatitja e fazës në terren
- Mbledhja e të dhënave dhe raporti për metodën
- Analiza e të dhënave dhe shkrimi i raporteve
- Aktivitetet propaganduese

Trajnerët duhet të kenë përgatitje të lartë teorike dhe metodologjike si shkencëtarë socialë, me ekspertizë të veçantë në fushën e hulumtimit në arsim. Ata duhet të kenë përvojë praktike me studimet gjurmuese, duke përfshirë shkrimin e raporteve për rezultatet.

1.12. Kërkesat minimale për studimet gjurmuese

Ky manual u përgatit me synimin për të ndihmuar institucionet e AFP-së për të kryer studime gjurmuese cilësore që sjellin përmirësime në ofertën e AFP-së dhe në sistemin e AFP-së në tërësi. Studime të tilla shpesh kërkojnë që personat përgjegjës për kryerjen e studimit, analizën e të dhënave dhe shkrimin e raportit të kenë kompetenca specifike. Aty ku nuk ekziston duhet të përdoret dhe përqafohet edhe përvoja praktike e anketave sasiore, në mënyrë që ngritja e sistemit për studimet gjurmuese të vazhdueshme institucionale të organizohet si një proces të nxëni; kjo është kërkesa minimale kyçe. Drejtorët e ofruesve të AFP duhet të jenë të vetëdijshëm se motivimi i stafit është faktor kyç. Për sa kohë që personat përgjegjës për studimin janë të motivuar për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme njohuritë dhe aftësitë e tyre sa i takon marrëdhëniet ndërmjet arsimit / formimit dhe punës dhe metodologjisë së studimeve gjurmuese, edhe rezultatet mund të jenë të një cilësie të lartë që mund të çojnë në përmirësime edhe në ofertë. Institucionet duhet ta vlerësojnë këtë punë dhe ta mbështesin me kohë të mjaftueshme pune dhe burime të tjera.

Shtojca 1 paraqet një version minimal të pyetësorit tip për një studim gjurmues institucional në AFP. Ai mund të përdoret si pikë fillestare për zhvillimin e pyetësorit të gjithsecilit institucion, me përshtatje sipas specifikave të programit të studimit / formimit, por pa bërë ndryshime të mëdha. Pyetësi është gati për t'u përdorur pasi pyetjet janë testuar në kuadër të projektit 'Aftësi për Punë'.

Gjatësia e pyetësorit nuk ndikon drejtpërdrejt në shkallën e përgjigjeve. Një pyetësor shumë i shkurtër siguron vetëm informacione shumë të kufizuara në lidhje me përvojën e të

diplomuarve në tregun e punës, por përpjekjet për të arritur një normë të mjaftueshme përgjigjeje janë pothuajse të njëjta si në rastin e një pyetësi më të gjatë dhe më të pasur. Rekomandohet përdorimi i një pyetësi në internet (*online*).

Çdo studim gjurmues kërkon një bazë të dhënash (mund të jetë një skedar në *Excel*) me informacion të vlefshëm në lidhje me kontaktet e të diplomuarve për të formuar një kornizë të përshtatshme për anketën. Verifikimi dhe përditësimi i të dhënave duhet të bëhet përpara fillimit të fazës së gjurmimit. Llojet e adresave të përdorura duhet të dokumentohen në raport.

Shpesh norma e përgjigjes përdoret si një tregues kyç për cilësinë e një ankete. Meqenëse shkalla e përgjigjes varet shumë nga lloji i përpjekjeve të kryera nga studiuesit dhe jo nga motivimi i brendshëm i të diplomuarve, rekomandohet që të dërgohen dy rilajmërim/kujtesa.

Në raportimin e gjetjeve, vëmendja duhet të përqendrohet që në fillim në këto dy aspekte: raporti për metodën e përdorur dhe interpretimi i gjetjeve.

Raporti për metodën duhet të informojë lexuesin për sa vijon:

- Objektivat e studimit gjurmues
- Pyetësin
- Popullsinë e synuar
- Bazën e të dhënave për adresat
- Aktivitetet për mbledhjen e pyetësorëve
- Shkallën e përgjigjes
- Përfaqësueshmërinë e të diplomuarve pjesëmarrës

Të paktën për pyetjet që lidhen me pyetjet kyçe të studimit duhet të bëhet edhe interpretimi i gjetjeve.

KAPITULLI 2 – OBJEKTIVAT KRYESORE TË STUDIMEVE GJURMUESE

Objektivat e studimeve gjurmuese janë shumë të ndryshme, por gjithsesi mund të identifikohen edhe disa elemente të përbashkëta. Disa studime gjurmuese prodhojnë vetëm gjetje të thjeshta përshkruese rreth situatës së punësimit të të diplomuarve, ndërsa studime të tjera përpiqen të shpjegojnë situatën e punësimit duke analizuar lidhjet midis punësimit dhe arsimit. Studimet gjurmuese të institucioneve të veçanta të AFP-së (ose programet e veçanta të studimit) mund të gjenerojnë informacion të vlefshëm për një gamë të gjerë veprimesh / funksionesh të institucioneve të AFP-së.

Një studim gjurmues duhet të:

- Jetë i vlefshëm për një gamë të gjerë aktorësh
- Mbulojë një gamë të gjerë aspektesh të punësimit dhe punës
- Japë disa shpjegime për shkaqet e suksesit profesional / rezultatet e punësimit
- Analizojë ndikimin e tipareve të ndryshme të arsimit për të përfituar informacion empirik për përmirësimin e mëtejshëm

Studimi duhet të hartohet në atë mënyrë që siguron gjenerimin e të dhënave, të cilat janë të vlefshme për nxitjen e përmirësimeve në institucionet e AFP-së.

2.1. Lidhjet midis arsimit dhe punësimit

Studimet gjurmuese janë shumë të vlefshme për mbledhjen e informacionit sistematik dhe të besueshëm për lidhjet midis studimit dhe punësimit dhe punës së mëvonshme. Studimet gjurmuese japin informacion mbi vendndodhjen e të diplomuarve disa kohë pas marrjes së diplomës dhe mund ta lidhin këtë me përshkruesit social-biografik dhe studimor (gjinia, mosha, fusha e studimit, institucioni që jep diplomën). Studimet gjurmuese bëjnë të mundur ilustrimin e karakteristikave të 'suksesit' në karrierë të të diplomuarve në përgjithësi. Për më tepër, ato tregojnë se cilët nxënës dhe nga cilët sektorët të AFP kanë ecuri më të mirë në këtë aspekt.

2.2. Relevanca e programit arsimor

Me qëllim analizimin e lidhjeve midis arsimit dhe punës, studimet gjurmuese mund të përfshijnë edhe disa aspekte të punësimit dhe punës, si dhe përvojat e mëparshme të të nxënësve. Anketa mund të mbulojë një gamë të gjerë të rezultateve të punësimit dhe punës:

- Statusin e punësimit
- Pagën
- Orët e punës
- Llojin e kontratës
- Detyrat tipike në një vend pune
- Kërkesat e punës
- Kënaqshmërinë në punë

- Përdorimin e njohurive
- Lidhjet midis nivelit arsimor dhe pozicionit

Studimet mund të trajtojnë shumë tema, të cilat mund të lidhen 'rastësisht' me njëra-tjetrën dhe që nuk kufizohen vetëm në pika të thjeshta përshkruese:

- Parakushtet individuale të studimit (të dhënat e nxënësve), siç janë përkatësia gjinore, prindërore dhe rajonale, motivimet dhe aftësitë
- Burimet, kushtet e studimit dhe ofertat e studimit (*input*-et siç janë kurrikula, motivimet dhe aftësitë e mësimdhënësve)
- Procesi mësimor (mësimdhënia dhe të nxënës)
- Zhvillimi i kompetencave (produkti)
- Kalimi nga arsimi në punë (rezultati)

Nevojitet një gamë e gjerë kriteresh që kanë të bëjnë me suksesin profesional (përfitimet nga arsimi). "Përputhja" mes kërkesave të tregut të punës dhe shoqërisë në përgjithësi do të analizohej shumë ngushtë, nëse lidhjet midis fushës së studimit dhe fushës së punës do të ishin baza e vetme e informacionit. Studimi gjurmues duhet të mundësojë matjen e:

- Përputhjes horizontale (lidhja e fushës së studimit me detyrat që duhen kryer në punë, shkalla e përdorimit të njohurive dhe aftësive të fituara gjatë studimit)
- Përputhjes vertikale (pozicioni i duhur lidhur me nivelin e arsimit, nivelin e pagave dhe kushtet e tjera të punësimit)

Përputhja e ulët horizontale (mospërputhja e aftësive) mund të merret si një sinjal për përshtatjen e kurrikulës, por nxjerrja në pah e implikimeve të tilla sa i takon politikave do të ishte kuptimplotë vetëm nëse merren parasysh edhe faktorë të tjerë të mundshëm, si për shembull:

- A kombinohet mospërputhja e aftësive me përputhjen e ulët vertikale?
- A është mospërputhja e aftësive një fenomen i përkohshëm që ndikohet nga cikli ekonomik?
- A është mospërputhja e aftësive një përvojë tipike e të diplomuarve të rinj në fazën e tranzicionit për të gjetur një punë më të përshtatshme dhe më të qëndrueshme (efekti i ciklit jetësor)?
- A janë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimit më të rëndësishme në fazat e mëvonshme të karrierës?

Është e qartë se studimet gjurmuese mund t'i japin përgjigje shumë prej këtyre pyetjeve, duke pasur parasysh se pyetësi ka një fushështrirje të gjerë dhe nëse hartimi i studimit gjurmues është bërë në atë mënyrë që të mundësojë mbledhjen e përgjigjeve nga të diplomuarit që kanë përvojë të vërtetë pune pas diplomimit. Studimet gjurmuese kanë edhe kufizime. Për shembull, ata mund të kenë mungesë informacioni sa i takon kontekstet më të gjerë të tregut të punës, prandaj duhet të kombinohen me burime të tjera të të dhënave dhe me metoda për parashikimin dhe përputhjen e aftësive.

Studimi gjurmues mundëson mbledhjen e një game të gjerë informacioni për një të diplomuar, në mënyrë retrospektive, si:

- Objektivat e të nxënësve para regjistrimit në arsimin e lartë
- Kursin e studimit dhe kompetencat
- Kushtet dhe ofertat e studimit të përjetuara
- Sjelljen personale gjatë studimit

Analiza statistikore jo vetëm që do të gjenerojë gjetje të thjeshta përshkruese, por do të përpiqet të shpjegojë edhe shkaqet e suksesit profesional dhe të analizojë edhe ndikimin e tipareve të ndryshme të AFP-së, si:

- Sa e rëndësishme është AFP për formësimin e kompetencave gjatë diplomimit?
- Deri në çfarë mase janë fituar kompetencat e duhura për punësimin dhe punën e mëvonshme, krahasuar me strategjitë e kërkimit dhe me kriteret e tjera të rekrutimit?

Studimi gjurmues i një institucioni të AFP-së duhet të marrë parasysh sa më sipër. Një studim kompleks mund të jetë i vlefshëm për sigurimin e të dhënave jo vetëm sa i takon shkallës së suksesit profesional, por edhe në lidhje me shumë dimensione të suksesit në karrierë dhe të faktorëve të cilët janë të rëndësishëm dhe kontribuojnë në arritjen e këtij suksesi. Këto nuk duhet të krahasohen thjesht me mesataren kombëtare apo me të diplomuarit nga fusha specifike e studimit, por duhet të përfshijnë edhe rolin e luajtur nga karakteristikat e institucioneve të veçanta të AFP-së dhe programet e studimit të ofruara nga ata.

2.3. Vlerësimi i rezultateve në sigurimin e cilësisë

Studimet gjurmuese jo vetëm që matin produktin / rezultatin, por mund të ndihmojnë edhe për shpjegimin e tij duke bërë kështu të mundur vlerësimin e impaktit bazuar në të dhëna. Ky informacion mund të përdoret për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit në aspektin e sigurimit të cilësisë. Një qasje e avancuar ndaj studimeve gjurmuese duhet të ndihmojë institucionin e AFP-së për të mbledhur informacion, për të nxjerrë në dritë mangësitë e mundshme në një program arsimor të caktuar dhe për të shërbyer si bazë për aktivitetet e ardhshme në lidhje me planifikimin. Për këtë, nevojitet informacion për suksesin profesional (karriera, statusi, të ardhurat) të të diplomuarve, si dhe informacion mbi rëndësinë e njohurive dhe aftësive.

Gjithashtu, të diplomuarve mund t'u kërkohej që të vlerësojnë në mënyrë retrospektive edhe kushtet dhe ofertat e studimit. Kjo i ndihmon anketat e të diplomuarve për të dhënë informacion të vlefshëm mbi konceptin e mësimdhënies në lidhje me kompetencat e punës / kompetencat kyçe.

2.4. Orientimi i karrierës dhe marketingu institucional

Informacioni nga studimet gjurmuese mund të ndihmojë orientimin profesional të nxënësve aktualë dhe të ardhshëm. Ekziston edhe mundësia për të përdorur kontaktet me nxënësit e mëparshëm për të:

- Prezantuar përvojën personale
- Sistemuar nxënësit në praktika
- Krijuar kontakte ndërmjet nxënësve dhe tregut të punës

Të dhënat e studimit gjurmues mund të përdoren edhe si burim informacioni për studimin dhe karrierën, duke përfshirë të dhënat nga ofruesit e shërbimeve të punësimit së bashku me të dhënat për vendet e lira dhe aplikantët për punë. Të dhënat mund të përdoren për të analizuar faktorët e suksesit dhe mund të mbështesin nxënësit në zgjedhjen e specializimeve, ndërsa vetëvlerësimi nga të diplomuarit (kompetencat, kërkesat e punës, kriteret për sukses) mund të nxjerrë në pah përfitimet që rrjedhin nga kualifikimet kryesore dhe nga kualifikimet e mëtejshme.

2.5. Informacioni për aktorë të ndryshëm

Njohja e fushave të punësimit, lëvizshmërisë dhe kënaqshmërisë së të diplomuarve ndihmon në pozicionimin e përgjithshëm të institucionit të AFP-së dhe është e dobishme për palët e tjera të interesit, si:

- Institucionet përkatëse qeveritare
- Punëdhënësit
- Agjencitë e punësimit
- Shoqatat profesionale
- Mësuesit dhe drejtuesit në institucionet e AFP-së
- Nxënësit e ardhshëm dhe prindërit e tyre
- Nxënësit
- Të diplomuarit vetë

Këto objektiva mund të arrihen vetëm nëse rezultatet e studimit gjurmues ndahen me palët e interesuara dhe / ose bëhen publike.

2.6. Rrjetet e ish-nxënësve (alumni)

Studimet gjurmuese mund të mbështesin punën e një institucioni të AFP-së me ish-nxënësit, duke:

- Krijuar një bazë të pasur të dhënash me adresat e të diplomuarve të anketuar për të bërë të mundur lidhjen afatgjatë të të diplomuarve me institucionin e AFP-së
- Kërkuar informacion në lidhje me interesin e mundshëm të të diplomuarve për arsimim të mëtejshëm
- Mbledhur informacion në lidhje me karrierën e ish-nxënësve, përvojën e tyre në tregun e punës dhe suksesin e tyre afatgjatë në punë, gjë që bën të mundur kryerjen e një vlerësimi nga zyra për ish-nxënësit

KAPITULLI 3 – HARTIMI I STUDIMIT GJURMUES

Zhvillimi i një studimi gjurmues është një proces kompleks, sepse çdo vendim i marrë në një fazë të caktuar ka pasoja edhe për fazat e tjera. Ky kapitull i përgjigjet pyetjeve kyçe, të cilat duhet të adresohen në fazën e hershme të çdo studimi gjurmues:

- Cilat janë objektivat e studimit gjurmues?
- Cilët nxënës / të diplomuar duhet të ftohen për të marrë pjesë?
- Cilat instrumente anketimi do të përdoren?

3.1. Cikli i hartimit të studimit gjurmues

Në fazën e hershme të studimit gjurmues duhet të merren vendime në lidhje me:

- Popullsinë e synuar (të cilët do të ftohen për të marrë pjesë në anketë)
- Kohën pas diplomimit kur duhet të bëhet anketa
- Metodën e grumbullimit të të dhënave (pyetësor në internet ose letër)
- Llojin e anketimit (studim me të dhëna cross-sectional ose panel)
- Mbulimin e anketës (me kampion ose census)

3.2. Popullsia e synuar

Shumica e studimeve gjurmuese fokusohen në një grup homogjen nxënësish / kursantësh që i kanë përfunduar studimet e tyre në të njëjtin vit, të njohur si një *grup/brez* (dmth: të diplomuarit e vitit 2018).

Sipas praktikave më të mira në shumë vende këshillohet përzgjedhja e vetëm një grupi/brezi si popullsia e synuar. Arsyeja kryesore për zgjedhjen e vetëm një brezi lidhet me faktin që me kalimin e kohës kushtet për kalimin në tregun e punës dhe përvojat arsimore mund të ndryshojnë. Mendohet që kushtet për një brez të caktuar janë të ngjashme dhe të krahasueshme. Dallimet ndërmjet brezave (nëse studimi gjurmues bëhet çdo vit) quhen 'efektet e brezit' nëse ato mund të dallohen nga efektet e një ankete që bëhet në një vit të caktuar (efekti i kohës historike) ose në një kohë specifike pas diplomimit (efekti i moshës).

Për një interpretim të besueshëm të përvojave të tregut të punës dhe situatës profesionale të ish-nxënësve, është gjithmonë e nevojshme të merret parasysh konteksti përkatës, i cili mund të ketë ndryshuar në një kohë të shkurtër. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për vendet ku ka patur ndryshime strukturore në sistemin arsimor si edhe në kohë krize ekonomike.

Nëse studimet gjurmuese kryhen rregullisht (çdo vit), atëherë është e mundur që të krahasohen rezultatet e sondazheve të ndryshme për të analizuar ndryshimet me kalimin e

kohës (analiza e trendit). Në rastet kur kanë ndryshuar programet e studimit, krahasimet midis brezave të diplomuar do të shërbenin si një analizë interesante e efekteve të shkaktuara nga këto ndryshime. Ndryshimet midis brezave të diplomuar në disa aspekte të vlerësimit të tyre të kushteve të studimit ose suksesit profesional mund t'i atribuohen dallimeve në përvojat e tyre arsimore (efekti i brezit), vetëm në rastet kur nuk ka ndryshuar situata në tregun e punës.

! Vetëm një brez i të diplomuarve duhet të zgjidhet si popullsia e synuar.

3.3. Koha pas diplomimit

Sa kohë duhet të ketë kaluar para sa të diplomuarit të ftohen të marrin pjesë në studim? Nëse objektivi i studimit është përmirësimi i një programi studimi, atëherë shumica e të diplomuarve duhet të kenë arritur kalimin drejt punësimit dhe të kenë përvojë pune. Një studim i kryer rreth gjashtë muaj pas diplomimit konsiderohet si shumë i hershëm, sidomos kur kushtet e tregut të punës janë të dobëta për të diplomuarit e rinj dhe shumica e të diplomuarve janë ende në kërkim të punës së tyre të parë.

Të diplomuarit e rinj në shumë vende janë në kërkim të punës së tyre të parë për gjysëm viti. Më pas ata fillojnë të merren me detyra specifike që duhet t'i mësojnë për të përballuar kërkesat e punës. Kryesisht bëhet fjalë për situatat e trajnimit në vendin e punës, por nganjëherë të diplomuarve iu ofrohen edhe programe formimi formale. Prandaj, rekomandojmë që si popullsi e synuar për anketën të përzgjidhen vetëm personat të cilët janë diplomuar të paktën një vit më parë. Një anketë e kryer rreth dy vite pas diplomimit mund të jetë një kombinim i mirë midis qasjes tek të diplomuarit (jo shumë kohë më parë), fazës së tranzicionit dhe karrierës dhe përvojës së hershme të punës.

! Studimi gjurmues në nivel ofruesi duhet të bëhet 9-12 muaj pas diplomimit.

3.4. Metodat për mbledhjen e të dhënave

Vendimet në lidhje me të dhënat përfshijnë:

- Shkallën e standardizimit të pyetësorit
- Metodën e kontaktimit të të diplomuarve (e-mail, telefon, media sociale)
- Metodën e mbledhjes së të dhënave (intervistë, pyetësor i vetë-administruar në internet ose pyetësor në letrës)

Metoda

Intervistë individuale

Anketë me postë

Anketë në telefon

Anketë në internet

Komente

Merr shumë kohë dhe është e kushtueshme

Varet nga ekzistenca e adresave

Përdoret vetëm me raste

Metoda e rekomanduar; metoda më efikase

Intervistat përdoren kryesisht:

- Kur priten shumë pak përgjigje - për të inkurajuar përgjigjen
- Kur plotësimi i pyetësorit është shumë i vështirë - për të lehtësuar procesin
- Për të mbledhur të dhëna cilësore

Megjithatë, intervistuesit nuk janë të përfshirë në pyetësorët e vetë-administruar, pyetjet duhet të jenë të mirëformuluara dhe të testohen për t'u siguruar që janë pyetje të qarta të cilave të diplomuarit mund t'ju përgjigjen lehtësisht pa patur nevojë për shpjegim të mëtejshëm. Ftesat për të marrë pjesë në një anketë të vetë-administruar mund të dërgohen me anë të postës elektronike ose përmes një ftese me anë të një linku me pyetësorin në internet.

Përdorimi i anketave në internet ka shumë përparësi:

- Kostot e reduktuara, pasi nuk nevojiten pyetësorë në letër dhe as hedhja e të dhënave
- Rezultatet e studimit dalin shumë shpejt
- Nuk kërkon staf të specializuar për hedhjen e të dhënave
- Pyetësi mund të përshtatet për grupe të ndryshme (me anë të filtrave), dhe për këtë arsye mund të duket edhe më i shkurtër

Megjithatë, duhet të merren parasysh edhe disa disavantazhe. Ndonjëherë përqindja e pyetësorëve të paplotësuar duket e lartë. Problemet teknike që kanë të bëjnë me qasjen në internet dhe shfletuesit e shumtë që përdoren (p.sh. *Firefox, Internet Explorer, Opera, Safari*) dhe *hardware* (PC, *notebook*, tabletë, telefon i zgjuar) kufizojnë kontrollin e rrugës nëpërmjet të cilës merret pyetësi nga të diplomuarit.

! Përdorni pyetësorët e standardizuar si metodë anketimi dhe shpërndajini me anë të postës elektronike ose si një pyetësor në internet.

3.5. Studimi i natyrës cross-sectional kundrejt studimit me të dhënat panel

Shumica e anketave të të diplomuara janë studime të natyrës cross-sectional: një grup/brez të diplomuarish anketohet vetëm në një moment të caktuar kohor, për shembull, një vit pas diplomimit. Studimet me të dhënat panel, gjatë të cilave të njëjtët persona anketohen në disa periudha të ndryshme kohore, janë të rralla. Studimet me të dhënat panel janë të nevojshme për të marrë informacion në lidhje me ndryshimet individuale, duke kombinuar përgjigjet e individëve në kohë të ndryshme. Caktimi i numrave identifikues në anketën e parë, shoqëruar edhe me emrin dhe adresën, mund të ndihmojë në krahasimin e të dhënave për të njëjtin individ në anketimet e mëvonshme.

! Studimi i natyrës cross-sectional (të diplomuarit e pyetur vetëm në një moment të caktuar kohor) preferohet më shumë sesa studimi me të dhëna panel (të njëjtët të diplomuar të pyetur në momente të ndryshme kohore).

3.6. Studimet e rregullta gjurmuese

Studimet e rregullta gjurmuese duhet të synojnë ta shohin vlerësimin / marrjen e mendimeve si një proces të përhershëm, pasi edhe kushtet / kërkesat e kurseve të studimit janë në ndryshim të vazhdueshëm. Studimet gjurmuese që zbatohen rregullisht, sigurojnë marrjen e dhënave të vlefshme për kohë të ndryshme.

Studimet gjurmuese institucionale që kryhen rregullisht çdo vit bëjnë të mundur krahasimin e rezultateve me kalimin e kohës. Për shembull, nëpërmjet anketës mund të kërkohej të merret përgjigje nëse përmirësimi i kushteve dhe ofertave të studimit është i dukshëm edhe në rezultatet e punësimit. Studimet vjetore gjurmuese bëjnë të mundur edhe vazhdimin e procesit të të nxënies, pasi stafi i institucioneve i trajnuar ashtu siç duhet ka mundësi që të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë e tij pa ndërprerje. Nëse numri i të diplomuarve të disa programeve të vogla studimore nuk mjafton për kryerjen e analizës së të dhënave, atëherë mund të bëhet bashkimi i të dhënave të dala nga dy ose më shumë anketa për të përfutur një numër të mjaftueshëm rastesh.

! Studimet gjurmuese në nivel ofruesi duhet të kryhen rregullisht (dmth çdo vit).

3.7. Kërkesat për studimet gjurmuese në nivel ofruesi

Burimet e nevojshme për një studim gjurmues fillojnë me një përpunues teksti (*word processor*) dhe programin e përshtatshëm. *Microsoft Word*, si pjesë e paketës së *Microsoft Office*, është programi më i përdorur dhe është baza e shembujve të pyetësorëve, librave të kodeve dhe raporteve në këtë udhëzues. Alternativat përfshijnë *freeware OpenOffice*. *KoBO Toolbox (freeware dhe open source)* është i mirë për kryerjen e anketave në internet.⁴

Përveç koordinatorit të studimit gjurmues, i cili duhet të menaxhojë të gjithë studimin, ekipi duhet të ketë edhe kompetencat e mëposhtme:

- njohuri dhe përvojë të përparuar me programet e duhura të përpunimit të tekstit, veçanërisht me formatimin;
- njohuri të përparuara dhe përvojë me *SPSS* (përdorimi i sintaksës *SPSS* duhet të njihet mirë), *Stata* ose *R*;
- njohuri të koncepteve bazë statistikore siç janë mesatarja *mean*, varianca, kovarianca dhe analiza e korrelacionit të variancës dhe analiza e regresionit.

⁴ <https://www.kobotoolbox.org/>

Tabela 1 Kërkesat për programe (software) për një studim gjurmues

Aktiviteti	Lloji i kërkuar i programit	Rekomandim
Formatimi i pyetësorit dhe shkrimi i kodit	<i>Përpunues teksti (Word processor)</i>	<i>Microsoft Office Word</i>
Administrimi i pyetësorëve, kontrollimi i kthimeve	<i>Baza e të dhënave (Database)</i>	<i>Microsoft Office Excel/Access</i>
Hedhja e të dhënave (e aplikueshme vetëm për pyetësorët në letër)	<i>Baza e të dhënave (Database)</i>	Programi për pyetësorët në internet p.sh <i>KoBo Toolbox</i> ose <i>Microsoft Access</i>
Analiza e të dhënave	<i>Program statistikor</i>	<i>SPSS</i> ose <i>R</i> ose <i>Stata</i>
Tabelat/grafikët	<i>Programi për tabelat/grafikët)</i>	<i>Microsoft Excel</i> ose <i>SPSS</i> ose <i>R</i>
Prezantimet	<i>Programi për prezantime</i>	<i>Microsoft PowerPoint</i>
Shkrimi i raportit	<i>Përpunues teksti</i>	<i>Microsoft Office Word</i>

! Kërkesat për programe kompjuterike për studimet gjurmuese në nivel ofruesi përfshijnë një përpunues teksti (p.sh. Microsoft Office Word), një bazë të dhënash (p.sh. Microsoft Office Excel), një program për administrimin e pyetësorit (p.sh. KoBO Toolbox) dhe një program statistikor për analizën e të dhënave (p.sh. SPSS)

3.8. Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave duhet të kryhet me anë të programit statistikor. SPSS është ndoshta programi më i përhapur i këtij lloji. Është praktik, i dokumentuar shumë mirë (mund të gjenden manuale të shkëlqyera për përdorimin e tij) dhe relativisht i lehtë për t'u përdorur.

3.9. Koha për kryerjen e studimit dhe detyrat kryesore gjatë studimit

Në përgjithësi, një studim gjurmues mund të përfundojë brenda 6-12 muajsh dhe kërkon ndjekjen e tre hapave bazë:

- Zhvillimi i konceptit dhe instrumenteve; përgatitja për mbledhjen e të dhënave
- Mbledhja e të dhënave me rilajmërimë për kujtesë
- Analiza e të dhënave dhe shkrimi i raporteve, aktivitetet propaganduese

Fazat e një studimi gjurmues, detyrat kryesore dhe kohëzgjatja

Faza	Detyrat kryesore	Kohëzgjatja 6 muaj	Kohëzgjatja 12 muaj
1. Zhvillimi i konceptit dhe i instrumenteve	- Përcaktimi i objektivave të anketës (përzgjedhja e temave për të cilat do të drejtohen pyetje) - Hartimi i anketës (përzgjedhja e grupeve të të diplomuarve që do të përfshihen) - Hartimi i konceptit teknik për kryerjen e anketës - Mbledhja dhe përditësimi i adresave - Përgatitja e pyetësorit - Testimi i pyetësorit	1 muaj	4 muaj
2. Mbledhja e të dhënave	- Dërgimi/ shpërndarja dhe mbledhja e pyetësorëve - Sigurimi i pjesëmarrjes së lartë (rilajmërimet për kujtesë)	2 muaj	4 muaj
3. Analiza e të dhënave dhe shkrimi i raportit	- Përcaktimi dhe kodimi i përgjigjeve të hapura - Redaktimi i të dhënave (kontrolli i cilësisë) - Analiza e të dhënave - Përgatitja e raportit të anketës - Seminar pune me nxënës, të diplomuar dhe punëdhënës - Veprime të mëtejshme për të përmirësuar programin e studimit	3 muaj	4 muaj



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC




swisscontact

KAPITULLI 4 - ZHVILLIMI I PYETËSORIT

Ky kapitull paraqet çështjet kyçe që lidhen me zhvillimin e pyetësorëve të standardizuar, përkatësisht:

- Llojet e pyetjeve të anketës që mund të përdoren në studimet gjurmuese
- Shkallën e përdorur në pyetësor
- Sekuencën e pyetjeve
- Pilotimin e pyetësorit
- Formatin e letrës shoqëruese

4.1. Pyetësi i standardizuar

Pyetësi i përdorur në studimet gjurmuese zakonisht është tejet i standardizuar. Përgjigjet e mundshme janë të gatshme dhe të formuluar paraprakisht dhe të anketuarit më së shumti i zgjedhin përgjigjet e tyre nga një listë. Përgjigjja e pyetjes bëhet kryesisht duke zgjedhur / klikuar përgjigjen:

Shembull i një pyetje të standardizuar

Kur e ke filluar punën tënde të parë pas diplomimit?

- Kam filluar punë që para diplomimit
 - Në kohën e diplomimit
 - Më pak se 1 muaj pas diplomimit
 - 1 deri në më pak se 3 muaj pas diplomimit
 - 3 deri në më pak se 6 muaj pas diplomimit
 - 6 deri në më pak se 9 muaj pas diplomimit
-

4.2. Përshtatja e pyetësorit tip

Në këtë udhëzues mund të gjeni një pyetësor tip i cili do të shërbejë si bazë për anketat. Megjithatë, ky pyetësor duhet të përshtatet për çdo studim të veçantë, duke patur parasysh pikat e mëposhtme:

- **Përshtatjen e tij me objektivat e veçanta të studimit gjurmues.** Çdo anketë ka objektivat e veta dhe, si rrjedhojë, duhet ta vërë theksin në pyetje të caktuara. Disa pjesë të pyetësorit tip mund të plotësohen ose të shkurtohen, në varësi të objektivave të studimit dhe formulimit të pyetjeve që përdoren në të.
- **Përshtatjen e tij me ndryshimin e kushteve kombëtare.** Pyetësi tip mund të parashikojë deri në një masë të caktuar vetëm veçoritë specifike kombëtare, të cilat mund të ekzistojnë, për shembull, në sistemin arsimor dhe të punësimit. Pyetjet e ndryshme duhet të marrin parasysh kushtet specifike.

- **Përshtatjen e tij me karakteristikat e veçanta të një fushe studimi ose programi studimi.**
Pyetëtori tip mund të parashikojë pjesërisht tiparet e veçanta të një programi studimi, i cili mund të ekzistojë në fushën lëndore të të diplomuarve. Pyetjet e ndryshme duhet të marrin parasysh kushtet e veçanta të programit të studimit.

4.3. Gjatësia e pyetësorit

Gjatësia e pyetësorit matet me kohën e nevojshme për plotësimin e pyetësorit, edhe pse kjo varet nga gjithsecili i diplomuar në veçanti. Të diplomuarit mund të kenë përvoja të ndryshme gjatë studimeve të tyre dhe pas diplomimit, gjë që ndikon në kohën e nevojshme për plotësimin e pyetësorit. Për shembull, të diplomuarve të papunë nuk do t'u kërkohej të japin përgjigje për pyetjen lidhur me punësimin por filtrohen drejt pyetjeve që kanë të bëjnë me to. Koha e deklaruar e nevojshme për të plotësuar një pyetësor është thjesht një mesatare, e cila mund të mos jetë e përshtatshme për disa grupe të diplomuarish.

Shpesh thuhet se një pyetësor më i shkurtër do të gjeneronte një shkallë më të lartë përgjigjeje. Megjithatë, kjo nuk na rezulton e vërtetë nëse krahasojmë anketat me pyetësorë të gjatësive të ndryshme. Shkalla e përgjigjes ndikohet nga disa faktorë, dhe gjatësia e pyetësorit nuk është aq e rëndësishme, për shembull, sa numri i rilajmërimeve të dërguara për kujtesë. Në vlerësojmë se pyetësori më i shkurtër mund të plotësohet në mesatarisht 5-10 minuta.

4.4. Pyetje të hapura

Formulimi i një pyetjeje të re që do të përfshihet në pyetësor merr shumë kohë me qëllim që të rezultojë pyetje 'e mirë'. Sugjerohet që në përgjithësi të shmangen pyetjet e hapura dhe të formulohen pyetje të mbyllura. Nëse duam të analizojmë përgjigjet për një pyetje të hapur nga ana sasiore (p.sh. Nëse kthehesh mbrapa në kohë, cila nga aftësitë praktike që ke fituar gjatë studimeve do të thoje se është më e dobishme në vendin tend të punës?), na duhet t'i kodojmë ato. Kodimi kërkon zhvillimin e kategorive të përgjigjeve brenda të cilave mund të përfshihen edhe përgjigje të ndryshme të veçanta.

Shembull i një pyetjeje të hapur

Nëse kthehesh mbrapa në kohë, cila nga aftësitë praktike që ke fituar gjatë studimeve do të thoje se është më e dobishme në vendin tënd të punës?

a. Të lutem specifikoj: _____

4.5. Pyetje të mbyllura

Formulimi i një pyetjeje të mbyllur kërkon formulimin si të pyetjes ashtu edhe të përgjigjeve të mundshme. Gama e përgjigjeve të propozuara duhet të jetë e plotë, ku të përfshihen të gjitha përgjigjet e mundshme.

Shembull i një pyetjeje të mbyllur

A ke kërkuar për punë në këto 4 javët e fundit?

- a. Po
- b. Jo

4.6. Ndryshoret, kodet dhe vlerat

Të gjithë personat e angazhuar për kryerjen e një studimi gjurmues duhet të kenë një ide bazë në lidhje me termat themelore që përdoren në çdo studim të këtij lloji: ndryshoret, kodet dhe vlerat.

Shpjegimi i ndryshoreve, vlerave dhe kodimeve

Ndryshoret	Përgjigjet e koduara të të intervistuarve për një pyetje të caktuar Shembull: Çfarë gjinie jeni? a. Mashkull b. Femër
Vlerat/kodimi	Përgjigjet e mundshme për pyetjen janë 'Mashkull' i cili është koduar me 1 dhe 'Femër' i cili është koduar me 2. Shifrat të cilat u janë caktuar kategorive të përgjigjeve si: 1 = Po, 2 = Jo. 1 dhe 2 janë 'vlerat' e ndryshores 'gjinia'.

4.7. Shkalla e matjes

Literatura përcakton katër lloje ndryshoresh, të lidhura me shkallë të ndryshme të matjes:

- Shkalla kategorike ose nominale
- Shkalla ordinale (numërore)
- Shkalla intervale
- Shkalla metrike

Pasojat për analizën e mëvonshme të të dhënave janë shumë të rëndësishme në formulimin e pyetjeve. Sa më i lartë niveli i matjes, aq më shumë procedura për analizën statistikore të të dhënave mund të përdoren.

4.8. Pyetje në shkallën kategorike ose nominale

Në përgjigjet e shkallës kategorike ose nominale, kodet ose vlerat që lidhen me përgjigjet nxjerrin në pah vetëm ndryshimin nga njëra-tjetra, por jo klasifikimin.

Shembull për shkallën kategorike ose nominale

Gjinia

- a. Mashkull
 - b. Femër
-

Ne e matim ndryshoren 'gjinia' me ndihmën e shkallës nominale të përgjigjeve. Kodet shërbejnë vetëm për të dalluar kategoritë e përgjigjeve. Çdo shifër mund të përdoret si kod. Vlera e shifrave nuk është e rëndësishme për analizën e mëvonshme të të dhënave; është e domosdoshme që kategoritë e veçanta të përfaqësohen me shifra të ndryshme.

4.9. Pyetje të hapura

Shembulli më poshtë ilustron një pyetje që iu drejtohet të diplomuarve për të kuptuar mënyrën se si i ka ndihmuar shkolla për të gjetur punën e tyre të parë. Megjithatë, duhet të kemi parasysh që disa të diplomuar mund të kenë pasur përvoja të ndryshme në këtë drejtim. Të gjitha përgjigjet e tjera të mundshme përfshihen në kategorinë 'tjetër', e cila u mundëson të intervistuarve të përshkruajnë 'rastin e tyre të veçantë' brenda kategorive tona. Nuk duhet të krijojmë një kategori të veçantë për çdo përgjigje të mundshme.

Shembull i një pyetjeje me përgjigje kategorike (shkalla kategorike ose nominale)

Si të ka ndihmuar shkolla për të gjetur punën tënde të parë pas diplomimit?

- a. Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë
 - b. Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit
 - c. Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë
 - d. Tjetër (të lutem specifikoj): _____
 - e. Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar
-

Ndërsa kontrollojmë pyetësoin, duhet të shohim edhe nëse përgjigjja e regjistruar në kategorinë 'tjetër' mund të përfshihet në ndonjë nga kategoritë e tjera ekzistuese. Kategoria kolektive 'tjetër' përdoret në rastet kur priten përgjigje të tjera dhe nuk mund/ nuk do të propozohet me hollësi.

4.10. Përgjigje të shumëfishta

Pyetjet me përgjigje të shumëfishta janë një lloj i rëndësishëm pyetjesh të cilave të intervistuarit mund t'u përgjigjen duke shenjuar në një listë me elemente të caktuara atë numër përgjigjesh që mendojnë se janë të përshtatshme.

Shembull për përgjigje të shumëfishta

Brenda dy viteve të ardhshme, çfarë dëshiron të kesh arritur? [Më shumë se një alternativë e mundshme]

- a. Të jem punësuar
- b. Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit/trajnitimit
- c. Të kem filluar biznesin tim
- d. Të kem ndjekur studime të mëtejshme
- e. Të kem emigruar jashtë vendit
- f. Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit
- g. Tjetër (të lutem specifiko): _____

Çdo element i përgjigjes përbën një ndryshore. Shkalla e përgjigjeve nuk është e shprehur qartë, por ne e interpretojmë një element të shenjuar si të barasvlershëm me 'po' dhe faktin që asnjë element nuk është shenjuar me 'jo'. Në dosjen e të dhënave, 'pa përgjigje' (elementet që nuk janë shenjuar) regjistrohen me vlerën '0' = 'jo'. Nëse nuk është shenjuar asnjë element i pyetjes, ne e konsiderojmë të gjithë pyetjen si 'pa përgjigje', që do të thotë që të gjitha elementet e veçanta janë regjistruar në 'pa përgjigje'. Nëse është e mundur dhënia e përgjigjeve të shumëfishta, atëherë kjo duhet të pasqyrohet në pyetje si 'përgjigje të shumëfishta të mundshme'; në pyetësorin tip pyetjet që lejojnë përgjigje të shumëfishta e kanë përfshirë këtë tregues.

4.11. Përgjigjet ordinale (numërore)

Në disa pyetje, iu kërkojmë të diplomuarve për të bërë një vlerësim me pikë të përgjigjes me ndihmën e një shkalle me pesë pikë. Në raste të tilla, matja kryhet me një shkallë ordinale, dmth, një vlerë në shkallë jo vetëm që ndryshon nga të tjerët, por merr edhe një pozicion më të lartë ose më të ulët se të tjerët (rendi i radhitjes).

Shembull i një pyetjeje në shkallën ordinale

Në ç'skallë mendon se duhet të përmirësohen aspektet e mëposhtme në shkollë për t'i përgatitur më mirë të diplomuarit për tregun e punës? Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1=aspak dhe 5=jashtëzakonisht shumë

a. Infrastruktura	1	2	3	4	5
b. Kurrikulat	1	2	3	4	5
c. Tekset dhe materialet për të mësuar	1	2	3	4	5
d. Metodatat e mësimdhënies	1	2	3	4	5
e. Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	1	2	3	4	5
f. Praktika në shkollë	1	2	3	4	5
g. Praktika në biznes	1	2	3	4	5
h. Këshillimi i karrierës	1	2	3	4	5
i. Bashkëpunimi me bizneset	1	2	3	4	5
j. Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	1	2	3	4	5

Kategoritë e përgjigjeve nuk janë të shprehura me fjalë plotësisht, por vetëm fillimi dhe fundi i shkallës: 1 = aspak dhe 5 = jashtëzakonisht shumë. Çdo element është një 'pyetje' dhe një ndryshore në grupin e të dhënave. Megjithatë ndryshoret kanë vetëm nivel rendor matjeje dhe, për këtë arsye të gjitha ato procedura aritmetike që supozojnë se vlerat kanë të njëjtën distancë nga njëra tjetra (mesatarja *mean*, varianca) janë të përshtatshme, praktikisht ju mund të mos e ndiqni këtë kufizim në mënyrë strikte, por t'i trajtoni këto ndryshore sikur të ishin metrike. Shkallë të tilla përdoren në rastet kur të intervistuarit mund të pritët të japin një vlerësim me pikë.

Si rregull, shkallët duhet të paraqiten në të njëjtin drejtim. Nëse, për shembull, përdorni shkallën me pesë pikë, ku 1 = 'aspak' dhe 5 = 'jashtëzakonisht shumë', të gjitha shkallët tuaja duhet të orientohen në atë mënyrë. Për më tepër, ju nuk duhet të përdorni shkallë me pikë të ndryshme: nëse vendosni të përdorni një shkallë me pesë pikë, atëherë të gjitha shkallët në pyetësorin tuaj duhet të jenë të tilla.

Sa më i vogël numri i karakteristikave në shkallën e përgjigjeve, aq 'më i vështirë' është vendimi i të intervistuarve për të shenjuar përgjigjen e saktë. Përgjigjet me pikë janë më të dobishme kur mund të supozohet se të intervistuarit nuk kanë nevojë të japin një përgjigje të prerë 'po / jo'. Kur përdorni shkallët me pesë përgjigje të mundshme, është e rëndësishme që të gjitha shkallët të polarizohen në të njëjtën mënyrë.

Ndër shkallët e ndryshme, rekomandohet përdorimi i shkallëve me pesë pikë, e cila ka përparësitë e mëposhtme.

- Shkalla me pesë pikë është shkallë e pabarabartë; vetëm shkallët e pabarabarta mund të përshtaten me kurbën normale, e cila përbën një avantazh statistikor krahasuar me të gjitha shkallët e barabarta.
- Shkalla me pesë pikë i përafrohet në shumë vende përdorimit të notave të shkollës, që përbën një lloj metrike të përbashkët.

- Shkalla me pesë pikë është më e lehtë për t'u interpretuar se sa shkalla me shtatë pikë. Zakonisht ne numërojmë përgjigjet 1 dhe 2 (nëse shkalla varion nga 1 = 'shumë mirë' në 5 = 'shumë keq' dhe paraqet përqindjet e përgjigjes 'mirë').

4.12. Niveli metrik i matjes

Në anketat e shkencave sociale maten vetëm disa ndryshore të shkallës intervale. Si shembuj këtu mund të përmendim të ardhurat, moshën dhe periudhën e punëkërkimit. Këto lloje të dhënash gjenerohen më së miri me ndihmën e një pyetjeje të hapur dhe mundësisht nëpërmjet klasifikimit të përgjigjeve në analizën e të dhënave.

Shembull për matjen metrike

Cila është data jote e lindjes?

a. Të lutem specifik

4.13. Rregullat për formulimin e pyetjeve

- **Pyetjet duhet të jenë në përputhje me kontekstin e anketës**
 - I intervistuari duhet të kuptojë arsyen përse i drejtohen pyetje të caktuara dhe që kjo është në përputhje me kuadrin e anketës.
- **Pyetjet duhet të jenë të sakta dhe të qarta**
 - Pyetje e dobët: A keni kërkuar punë për një kohë të gjatë?
 - Pyetje e mirë: Për sa kohë keni kërkuar punë?
- **Pyetjet duhet të shmangin deklaratat gjyquese/ vlerësuese**
 - Pyetje e dobët: A nuk mendoni edhe ju që duhet të hiqet praktika profesionale?
 - Pyetje e mirë: A mendoni edhe ju, që.... "?"
- **Pyetjet duhet të jenë neutrale**
- **Çdo pyetje dhe çdo element duhet të jetë i qartë**
 - Pyetje e dobët: A duhet që departamenti X të heqë praktikën në shkollë ose praktikën në biznes? Po / Jo.
- **Shmangni shkurtesat**
- **Përdorni gjuhë të thjeshtë dhe fjali të shkurtra**

4.14. Sekuenca e pyetjeve

Rëndësia e sekuençës së pyetjeve të veçanta mund të jetë, në fillim, më pak e dukshme sesa rregullat për formulimin e tyre. Kini parasysh që secila pyetje ndikon tek pyetjet e mëposhtme.

Pyetjet e para të një pyetësi janë shumë domethënëse pasi i tregojnë të intervistuarit se çfarë lloj pyetësi është, dhe kohën e nevojshme për ta plotësuar atë. Pyetjet e para duhet të jenë pyetje të cilave mund t'u jepet një përgjigje me shpejtësi dhe lehtësi. Supozohet se shkalla e vëmendjes / seriozitetit është më e ulët në fillim sesa në "mes" të pyetësit. Edhe kjo është një nga arsyet përse duhen bërë pyetje të thjeshta në fillim. Sidoqoftë, nga fundi, njerëzit mund të lodhen ose thjesht kanë dëshirë ta plotësojnë pyetësin sa më shpejt.

Pyetësi duhet të strukturohet në tema, të cilat shpjegojnë kontekstin e tyre për të intervistuarin përveç pyetjeve individuale. Struktura e temave në pyetësin e të diplomuarve duhet të ndjekë biografinë e të diplomuarve: studimin, tranzicionin, profesionin dhe planifikimin e mëtejshëm. Brenda temave të ndryshme, sekuenca e pyetjeve lind edhe nga kriteri formal nëse pyetjeve duhet t'i përgjigjen të gjithë të diplomuarit ose vetëm grupe të caktuara të të diplomuarve.

Filtrimi duhet të jetë sa më i lehtë që të jetë e mundur, kështu që në fillim duhet të parashtrohen pyetje të cilat vlejnë për të gjithë. Pyetësi tip përbëhet nga sekuenca të mëposhtme:

Seksioni I: Rezultatet në tregun e punës

Seksioni II: Lidhja midis edukimit të mëparshëm dhe punës aktuale

Të dhënat social-demografike

4.15. Letra shoqëruese

Letra shoqëruese i paraprin pyetësit. Si rregull, letra duhet të dërgohet nga institucioni i AFP-së me anë të cilës kërkohet pjesëmarrja në anketë. Ajo duhet të ofrojë siguri për trajtimin konfidencial të deklaratave të të intervistuarve.

Letra shoqëruese duhet të përmbajë gjithmonë:

- Përshkrimin e qëllimit të anketës
- Përdorimin e informacionit / të dhënave
- Deklaratën për mbrojtjen/ privatësinë e të dhënave
- Ofertën për të informuar pjesëmarrësin për rezultatet e anketës
- Informacionin rreth institucionit zbatues

Shihni formatin në Shtojcë.

4.16. Pilotimi

Para administrimit të anketës për herë të parë, duhet bërë pilotimi i pyetësit. Përzgjedhja e të diplomuarve në këtë fazë nuk synon të arrijë përfaqësim për një popullatë të përcaktuar, por të sigurojë një larmi të madhe të karrierave profesionale dhe të karakteristikave të tjera

individuale; kjo duhet të ndihmojë për të kuptuar nëse pyetësi është i vlefshëm për të gjithë të diplomuarit.

Në fazën e pilotimit mund të përfshihen të paktën 5 të diplomuar. Pilotimi duhet të kryhet në formën e një interviste. Në një intervistë të këtij lloji mund të vëzhgohen të diplomuarit ndërkohë që janë duke plotësuar pyetësin dhe, nëse nevojitet ndihmë, kuptohet qartë që pyetësi ka nevojë për përmirësim. Pilotimi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë pyetjeve të mëposhtme.

- A iu është dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve? Nëse jo, pse jo?
- A janë përcaktimet e filtrit të qarta dhe a janë ndjekur ato?
- Cilat pyetje janë të vështira për t'u kuptuar?
- Sa zgjat procesi?



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË



KAPITULLI 5 – MODULET E PYETËSORIT PËR NJË STUDIM GJURMUES

Përmbajtja e një pyetësoari varet nga objektivat specifike / pyetjet e studimit. Ky kapitull del me propozime në lidhje me pyetjet, të cilat janë shumë të zakonshme në studimet gjurmuese. Në pyetësoarin e paraqitur në Shtojcën 1 gjeni shembuj për detyrën e transformimit të objektiveve të anketimit në pyetje të veçanta dhe në një varg përgjigjesh të mundshme. Pyetësoari mund të përdoret pothuajse pa ndryshime, por rekomandohet edhe përshtatja e tij.

5.1. Pyetësoari gjurmues në AFP

Pyetjet dhe ndryshoret e pyetësoarit tip të studimit gjurmues në AFP.

Sek. Numri dhe titulli i modulit

- 1 I – Përfshirja në tregun e punës
- 2 II – Lidhja midis arsimit dhe punës aktuale
- 3 III – Të dhënat social-demografike

Një listë e temave kryesore të pyetësoarit tip

Moduli	Tema
I	Statusi i punësimit në kohën e anketimit Kohëzgjatja e punëkërkimit Metoda më e suksesshme për gjetjen e punës së parë Numri i vendeve të punës të ndërruara që nga diplomimi Arsyet për largimin nga puna e parë Spektori ekonomik i punësimit Vendndodhja e punës Lloji i punëdhënësit Madhësia e kompanisë, firmës, organizatës Pozicioni i punës Lloji i kontratës së punës Të ardhurat mujore neto Kënaqshmëria në punë Siguria e punës
II	Mënyrat e ndihmesës të ofruar nga shkolla Përshtatshmëria/lidhja e pozicionit me studimin Përputhja e punës me nivelin e kualifikimit / diplomës Përdorimi i kompetencave të fituara Propozime për përmirësim



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC




swisscontact

Vlerësimi i programit të studimit / formimit
Kënaqshmëria me zgjedhjen e institucionit të AFP-së
Kënaqshmëria me studimin në përgjithësi
Planet e ardhshme

III Emri i programit të studimit
Data e lindjes
Gjendja civile
Minoriteti
Zona e banimit

Moduli I: Përfshirja në tregun e punës

Fokusi i këtij moduli është kalimi nga studimet në profesion. Njëra nga pyetjet lidhet me strukturën kronologjike të këtij procesi, rrjedhën e tranzicionit. Pyetjet e mëposhtme i referohen strategjive për punëkërkimin. Këto pyetje i referohen vetëm herës së parë të kërkimit për punë. Meqë për arsye të ndryshme disa të diplomuar nuk kërkojnë punë pas përfundimit të studimeve të tyre, këtij filtri duhet t'i kushtohet vëmendje e konsiderueshme.

Temat e Modulit I përfshijnë:

- Statusin e punësimit pas diplomimit
- Kohën e pritjes deri në fillimin e punës së parë pas diplomimit
- Metodatat e punëkërkimit për punën e parë
- Arsyet për mos-kërkimin e punës

Për të diplomuarit të cilët janë aktualisht të punësuar, janë studiuar karakteristikat kryesore në lidhje me situatën aktuale të punësimit. Këtu duhet patur kujdes pasi disa prej të diplomuarve mund të mos kenë qenë të punësuar asnjëherë që nga përfundimi i studimeve të tyre ose ndoshta kanë qenë të papunë gjatë gjithë kohës kur u krye anketimi, por të punësuar më parë. Pyetjet në lidhje me situatën e punësimit duhet t'u drejtohen vetëm të diplomuarve që janë të punësuar në kohën e kryerjes së anketës.

Temat përfshijnë:

- Numrin e vendeve të punës që nga diplomimi
- Llojin e kontratës së punës
- Kohëzgjatjen e kërkimit për punën aktuale
- Kohëzgjatjen e përvojës së punës
- Llojin e punëdhënësit
- Sektorin ekonomik të punësimit
- Pozicionin e punës
- Detyrat kryesore në punë
- Të ardhurat mujore neto



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC




swisscontact

- Madhësinë e kompanisë / firmës / organizatës
- Karakteristikat e punësimit dhe punës
- Kënaqshmërinë në punë
- Sigurinë në punë

Për kategorinë e të diplomuarve të vetëpunësuar përdoren filtra të tjerë.

Për personat që ndjekin studime ose trajnime/kualifikime të mëtejshme, temat përfshijnë:

- Llojin e kualifikimit që ndjek
- Institucionin e studimit/ formimit të mëtejshëm
- Arsytet për studim / formim të mëtejshëm
- Perspektivat e ardhshme

Për personat që nuk janë të punësuar, temat përfshijnë:

- Arsytet kryesore të papunësisë
- Përvojën e mëparshme të punës

Moduli II: Lidhja midis arsimit dhe punës aktuale

Ky modul identifikon treguesit kryesorë për përputhjen dhe mospërputhjen e arsimit dhe punësimit. Të anketuarve u kërkohet të vlerësojnë masën në të cilën ata përdorin njohuritë dhe aftësitë e fituara (përputhja horizontale) dhe sa e përshtatshme është puna e tyre për nivelin e tyre arsimor (përputhja vertikale). Të gjitha pyetjet në këtë modul janë subjektive (të diplomuarit vlerësojnë situatën e tyre profesionale) dhe rezultatet duhet të analizohen së bashku me treguesit objektivë në Modulin I. Rëndësi e veçantë i kushtohet lidhjes midis profesionit / punës dhe studimeve. Kjo analizë bën të mundur deklarin e mendimit të tyre në lidhje me shkallën e përputhjes ndërmjet profesionit të tyre dhe njohurive dhe aftësive profesionale të përfutuara gjatë studimit të tyre.

Temat e Moduli II përfshijnë:

- Mënyrat e ndihmesës së ofruar nga shkolla
- Përshtatshmërinë/ lidhjen e pozicionit me studimin
- Përputhjen e punës dhe nivelit të kualifikimit / diplomës
- Përdorimin e njohurive dhe aftësive të fituara në punë
- Propozimet për përmirësim
- Vlerësimin e programit të studimit / formimit
- Kënaqshmërinë me zgjedhjen e institucionit të AFP-së
- Kënaqshmërinë me studimin në përgjithësi
- Planet e ardhshme

Moduli III: Të dhënat social-demografike

Kjo pjesë e fundit përqendrohet tek karakteristikat kryesore individuale të të diplomuarve, si viti i lindjes dhe gjinia. Nga shumë anketa të të diplomuarve kanë dalë një sërë supozimesh të konsiderueshme sa i takon dallimeve midis grupeve të të diplomuarve dhe këtyre karakteristikave biografike. Në disa studime, kjo temë është shumë më e diferencuar sesa propozohet këtu. Rekomandojmë që këto pyetje të vendosen në fund të pyetësorit, pasi të anketuarit mund ta kuptojnë më lehtë arsyen pse iu janë drejtuar pyetje të tilla. Gjithashtu, ato janë pyetje të lehta dhe nuk do të shërbejnë për intensifikimin e lodhjes që mund të ndjejnë të anketuarit në fund të intervistës. Ndryshoret demografike mund të gjenden pothuajse në të gjitha studimet gjurmuese.

Temat përfshijnë:

- Emrin e programit të studimit
- Gjininë
- Vitin e lindjes
- Gjendjen civile
- Përkatësia etnike
- Zonën e banimit
- Emrin e institucionit të AFP-së
- Datën e diplomimit

KAPITULLI 6. PËRGATITJA E FAZËS PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE

Një studim gjurmues nuk mund të bëhet pa kontributin e një ekipi. Studimet gjurmuese institucionale kërkojnë mbështetjen e drejtuesve të institucionit dhe bashkëpunimin me departamente të ndryshme. Elementi kyç për të qenë në gjendje për të filluar studimin gjurmues është baza e të dhënave me adresa të përditësuara.

6.1. Menaxhimi dhe organizimi

Ekipi duhet të krijohet që në fillim të fazës që do të zhvillohet në terren. Ky ekip duhet të mbulojë të paktën funksionet e mëposhtme:

- Koordinator i projektit (personi i kontaktit)
- Anëtarët e ekipit (menaxhimi i projektit, TI, shkrimi i raporteve, analiza statistikore)
- Partnerët e jashtëm

6.2. Para fillimit të studimit

Kontrolloni nëse është gati baza e të dhënave për adresat dhe sa adresa të vlefshme email-i përmban ajo. Shkruani një ftesë që përfshin adresën e internetit të anketës. Posta duhet të personalizohet (dmth. I nderuar Z. Bregu). Rekomandohet që ftesa të nënshkruhet nga drejtori i institucionit të AFP.

6.3. Baza e të dhënave për adresat

Baza e të dhënave duhet të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm për të kontaktuar të diplomuarit. Pika fillestare është lista e emrave të të gjithë të diplomuarve që i përkasin popullatës së synuar, për shembull, të gjithë ata që janë diplomuar në vitin 2017. Baza e të dhënave duhet të përmbajë edhe informacion mbi procesin, si për shembull:

- Nëse është përditësuar adresa
- Si u përditësua adresa
- Nga vjen adresa
- Kur është kontaktuar secili prej të diplomuarve për herë të parë (data)
- Si u kontaktua fillimisht secili prej të diplomuarve (telefon, e-mail, media sociale)

Ky informacion është i nevojshëm për të kontrolluar (por edhe për kërkesat e raportimit) të gjithë procesin e shpërndarjes së pyetësorëve në disa raste për të diplomuarit.

Përmbajtja e rekomanduar e bazës së të dhënave për adresat

Të gjitha të dhënat personale

- Emri, adresa, data e lindjes, etj.
- Drejtimi, profili

- Numri/numrat e telefonit
- E-mail
- Llogaritë e mediave sociale

Informacion *meta* për adresën dhe përditësimin e adresës dhe veprime të tjera

- Adresa
- Çfarë duhet bërë (p.sh. "kontakt i ri me ftesën e parë")
- Çfarë është bërë (p.sh. 'adresa e korrigjuar në Facebook')

Informacion për përgjigjen

- Data e përgjigjes
- Gatishmëria për të marrë pjesë në anketën pasuese: po / jo

Informacioni për proceset pas fazës në terren:

- Adresa e re (si adresa e e-mail, llogaritë e mediave sociale, numri i telefonit etj)
- Aspekte të tjera (p.sh. dëshiron të ketë kontakte me klubin e ish-nxënësve)

Në rastet kur nuk është e mundur që adresat aktuale të merren nga një regjistër i përditësuar, siguri i tyre mund të jetë një detyrë shumë e vështirë dhe që merr kohë. Për këtë arsye mund të përdoren disa metoda të ndryshme.

- Mbledhja e informacionit për adresat nga departamentet brenda institucionit
- Përdorimi i adresave të prindërve të të diplomuarve (të dhënat e regjistrimit)
- Përdorimi i shoqatave të ish-nxënësve, nëse ka
- Kontaktimi i të diplomuarve nëpërmjet punëdhënësve
- Përdorimi i teknikës 'snowball': kërkojini të diplomuarve që t'ju sigurojnë adresat e të diplomuarve të tjerë

Përdorimi i teknikës 'snowball' për zgjedhjen e kampionit/mostrës është shumë e përshtatshme, veçanërisht për studimet gjurmuese. Kjo përfshin kontaktimin fillestar të disa të diplomuarve të cilëve u kërkohet të japin adresat e miqve të tyre të cilët janë diplomuar së bashku me ta. Në këtë proces mund të vijnë në ndihmë Facebook-u dhe rrjetet e tjera.

6.4. Faqja e internetit të studimit gjurmues

Për studimin gjurmues mund të sigurohet menuja e një faqeje interneti për të:

- Prezantuar projektin për të diplomuarit
- Prezantuar studimin gjurmues tek personeli, palët e jashtme (prindër, institucione të tjera, qeveri, mjetet e komunikimit masiv)
- Sqaruar pyetjet
- Drejtuar të diplomuarit tek pyetësi (linku me pyetësin në internet)
- Prezantuar rezultatet (kur është e mundur)

Përmbajtja e faqes së internetit / menisë së faqes së internetit duhet të përfshijë të paktën sa më poshtë:

- Cilat janë objektivat e studimit gjurmues?
- Kush është i përfshirë?
- Kush po e koordinon?
- Si rrjedhin të dhënat e anketës?
- Kush po i përdor të dhënat?
- Si bëhet mbrojtja e të dhënave?
- Çfarë ndodh në projekt? A ka përfunduar anketa? Kur dalin rezultatet?

Kur një faqe interneti nuk është e realizueshme, ky informacion mund të ofrohet edhe në llogaritë zyrtare të mediave sociale të institucionit të AFP-së.

6.5. Fletëpalosje me informacion për studimin gjurmues

Nëse përdoren fletëpalosje, ato duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- Historikun e studimit
- Objektivat e studimit gjurmues
- Metodologjinë
- Programin
- Bashkëpunimin (nëse ka)
- Publikimet (nëse ka)
- Ekipin e studimit gjurmues
- Kontaktin e ekipit të studimit gjurmues

Fletëpalosja do t'u shpërndahet të diplomuarve, nxënësve, stafit të institucionit të AFP-së, institucioneve përkatëse, sektorit privat dhe palëve të tjera të interesit. Kjo audiencë e gjerë do të përcaktojë numrin e kopjeve që nevojiten. Shpërndarja tek nxënësit aktualë do t'i bëjë ata që të kuptojnë se në të ardhmen edhe ata do të ftohen për të marrë pjesë në studimin gjurmues.

6.6. Lista e kontrollit për grumbullimin e të dhënave

Pikat e mëposhtme mund të formojnë një pjesë të një liste kontrolli:

- A keni mbledhur informacion rreth popullsisë së synuar (numri i të diplomuarve sipas programit të studimit dhe gjinisë, përqindjet dhe numrat absolutë)?
- A i keni mbledhur adresat e kontaktit të popullsisë së synuar?
- A janë mbledhur adresat e kontaktit të të gjithë anëtarëve të popullatës së synuar? Nëse jo, cilat janë arsyet?

- A janë përditësuar të gjitha adresat? Nëse jo, sa prej tyre janë përditësuar? Si u bë përditësimi?
- A duhet të përdoren stimuj/incentiva?
- A e keni përditësuar faqen e shkollës / llogaritë e mediave sociale me linkun tek anketa në internet?
- A keni ofruar materiale të tjera informuese (p.sh. fletëpalosje)?
- A i keni njoftuar njerëzit përkatës (shërbimin e karrierës, shërbimin e ish-nxënësve)?
- A keni siguruar disponueshmërinë e stafit?



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË



swisscontact

KAPITULLI 7. AKTIVITETET GJATË FAZËS SË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave në të ardhmen, është e rëndësishme që kjo fazë të dokumentohet, mundësisht çdo ditë. Në këtë fazë mund të fillojë analiza statistikore. Kjo përfshin një kontroll të parë të pyetësorëve të plotësuar dhe përgatitjen e analizës.

7.1. Kontrolli i pyetësorëve të kthyer

Kontrolli i pyetësorëve të kthyer mund të kuptohet pjesërisht si një hap përgatitor për hedhjen e të dhënave. Rekomandojmë që pyetësorët e kthyer të kontrollohen sipas kriterëve të mëposhtme:

- **Grupi i synuar**

A është plotësuar pyetësori nga një anëtar i grupit të synuar? Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të verifikuar nëse adresat që kemi janë të sakta. Pyetësorët, të cilët nuk janë plotësuar nga anëtarët e grupit të synuar, lihen jashtë studimit por llogariten për përqindjen e kthimeve/përgjigjeve.

- **Plotësia**

Disa pyetësorë nuk mund të plotësohen si duhet pa patur një justifikim të mirë për këtë (siç është papunësia). Këto pyetësorë përgjithësisht lihen jashtë studimit, por llogariten për përqindjen e kthimeve. Kjo, nga ana tjetër, bëhet e parëndësishme kur pyetjet shënohen si të detyrueshme në pyetësorin në internet.

- **Serioziteti**

Nuk është e lehtë të përshkruhet se si mund të kontrollohet nëse pyetësori është plotësuar në mënyrë serioze. Në rastet e përgjigjeve dhe listës së gjatë të elementeve për pyetjet me shkallë prej pesë pikësh, për shembull, mund të mendohet se ka patur mungesë serioziteti nëse nuk mund të shihet një model i besueshëm për përgjigjet e shenjara. Ky kontroll mund të marrë shumë kohë nëse bëhet në mënyrë sistematike dhe është e vështirë të kuptohet se pse të anketuarit duhet të japin përgjigje të pamenduara/ jo serioze qëllimisht. Prandaj ne rekomandojmë vetëm një kontroll fillestar për shenja të mungesës së seriozitetit në fillim. Sidoqoftë, gjatë procesit të analizës së të dhënave është e mundur që ky lloj kontrolli të bëhet më sistematikisht.

- **Përgjigjet numerike të hapura**

Zerot para pikës dhjetore nuk duhet të plotësohen me patjetër, por gjatë kontrollit, vëmendje duhet t'i kushtohet faktit që të gjitha deklaratat janë kapur e kuptuar në mënyrë korrekte. Të gjithë numrat me më shumë se dy shifra (siç janë të ardhurat ose numri i të punësuarve) duhet të kontrollohen për të parë nëse janë kapur e kuptuar në mënyrë korrekte.

7.2. Rilajmërimet për kujtesë dhe shërbimi mbështetës (*helpdesk*)

Rilajmërimet për kujtesë janë masat më të fuqishme për të rritur shkallën e përgjigjes. Rekomandohet që të dërgohen të paktën dy rilajmërimet për kujtesë.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, të diplomuarit mund të kenë pyetje në lidhje me studimin gjurmues në përgjithësi ose në lidhje me gjëra specifike që kanë të bëjnë me pyetësin. Në rastet e anketave në internet mund të vërehen edhe probleme teknike. Nevojitet një shërbim mbështetës (*helpdesk*) dhe detajet e kontaktit duhet t'u jepen të diplomuarve: (a) në ftesë; (b) në fletëpalosjen për studimin gjurmues; (c) në faqen e internetit; (d) në pyetësin *online*.

Shërbimi mbështetës ka për qëllim t'u japë të anketuarve informacione dhe udhëzime dhe duhet të ofrojë mbështetje edhe për zgjidhjen e problemeve teknike, për shembull në rast të problemeve sa i takon qasjes tek pyetësi në internet.

7.3. Trajnimi i stafit të studimit gjurmues

Në rastet kur për zbatimin e anketës angazhohen edhe njerëz të tjerë, është e nevojshme që të organizohet një kurs trajnimi për ta. Forma dhe përmbajtja e kursit të trajnimit varet nga lloji i pjesëmarrjes së këtyre personave. I gjithë personeli i anketës duhet të ketë të njëjtat njohuri në lidhje me studimin dhe të ndjekë të njëjtat rregulla. Një kurs trajnimi njëditor për të gjithë ata që janë të interesuar të marrin pjesë në zbatimin e anketës duhet të mjaftojë. Informacioni mbi objektivat e studimit dhe pyetësi duhet t'u shpërndahet të trajnuarve paraprakisht. Nëse në zbatimin e anketës marrin pjesë edhe njerëz të tjerë, sigurohuni që të jenë të mirëtrajnuar.

KAPITULLI 8. ANALIZA E TË DHËNAVE

Ky kapitull do të trajtojë probleme të ndryshme në lidhje me analizën sasiore të të dhënave, si një hap shumë i rëndësishëm në studimin gjurmues. Pa këtë analizë nuk mund të arrihen objektivat e studimit gjurmues. Edhe pse janë ekspertët ata që e bëjnë analizën e të dhënave, rekomandohet që kapitulli i mëposhtëm të lexohet nga të gjithë për të kuptuar dhe vlerësuar rezultatet e proceseve.

8.1. Programet (software) për analizën e të dhënave

Për studimet gjurmuese ne rekomandojmë përdorimin e SPSS ose R.

- **SPSS:** SPSS është programi më i përdorur dhe më i dokumentuar për analizën e të dhënave statistikore. Është i lehtë për t'u mësuar. Për institucionet arsimore ofrohen oferta speciale me çmime relativisht të ulëta.
- **R:** R është një program i fuqishëm me burim të hapur (*open source*) i cili bën të mundur që të gjitha analizat e nevojshme të të dhënave të studimit gjurmues të bëhen pa asnjë kosto
- **Excel:** Nuk rekomandohet kryerja e analizës së të dhënave me anë të programit Excel, por disa analiza mund të bëhen me të. Organizata zvicerane *Helvetas* ka përgatitur një paketë me mjete në Excel për studimet gjurmuese, i cili është pa pagesë dhe mund të shkarkohet.
- **STATA,** si SPSS, përdoret gjerësisht në shkencat shoqërore. Ajo ka funksione të ngjashme statistikore, por është shumë më e lirë.

Hedhja e të dhënave për pyetësit në letër nuk është përfshirë në këtë udhëzues.

8.2 Kodimi

Pothuajse të gjitha pyetjet në pyetësin e të diplomuarve përfshijnë elemente të përgjigjeve të cilat janë koduar paraprakisht, dmth. për secilin prej tyre është caktuar një kod (shifër). Për analizën e mëvonshme të të dhënave ato mund të futen direkt. Për të koduar përgjigje të hapura, duhet të zhvillohet një listë kodesh. Është e rëndësishme të përcaktohen kategoritë kryesore, ku mund të përfshihen disa përgjigje individuale. Kuptimi i deklaratave të tilla mund të supozohet të jetë i njëjtë edhe kur përdoren shprehje të ndryshme. Megjithatë, për procesin e kodimit, kriteret për ngjashmëri duhet të jepen në librin e kodimit.

Nëse pyetjeve të hapura u përgjigjen vetëm disa të intervistuar, nuk ia vlen të planifikohet një analizë sasiore e të dhënave, por përgjigjet përsëri duhet të kapen si tekste dhe duhet të merren parasysh për formulimin e raportit të anketës. Si rregull, nëse janë marrë përgjigje nga më shumë se 5% e të intervistuarve, ato duhet të kodohen.

8.3. Rregullat për emrat e pyetjeve dhe ndryshoreve

Të gjithë emrat e ndryshoreve të të njëjtës anketë duhet të fillojnë me një shkronjë dhe të përmbajnë një tregues për pyetjen (ID) dhe elementin e pyetjes; për shembull, ndryshorja 'kënaqshmëria në punë' mund të ketë emrin '*kën. pu*'.

8.4. Analiza e thjeshtë e të dhënave: frekuencat

Hapi i parë në analizën e të dhënave aktuale është kryerja e numërimeve të thjeshta të frekuencës dhe nxjerrja e statistikave të agreguara (si mesatarja aritmetike) për të gjitha ndryshoret. Kjo është po aq e rëndësishme edhe për kontrollin e të dhënave. Avantazhi i procedurës së "përshkruesve" qëndron në formën kompakte të printimeve, pasi përshkruesit statistikorë së bashku me emrin e ndryshores dhe etiketën paraqiten në një vijë. Megjithatë, në kontrollin e të dhënave, përshkruesit statistikorë nuk kanë asnjë vlerë me interes: printimi i procedurës së "frekuencave" është thjesht i nevojshëm për të kontrolluar secilën prej ndryshoreve veçmas për të kuptuar nëse vlerat e saj duken të besueshme. Për lokalizimin e gabimit, dy janë rastet që duhet të dallohen.

- (a) A janë vlerat brenda fushës së lejuar të vlerave? Nëse, për shembull, përgjigjet e mundshme përfshihen vetëm midis nivelit 1 dhe 5 në fushën e vlerave, vlera 6 është e papranueshme; ky është një 'kod i egër' që dëshmon se janë bërë gabime në kapjen e të dhënave.
- (b) A janë vlerat të besueshme kur merren parasysh përgjigjet e mëtejshme të të njëjtit të intervistuar? Nëse një i intervistuar përgjigjet, për shembull, se nuk ka gjetur punë ende, ai nuk duhet të vazhdojë me përgjigje të tjera në lidhje me metodat e gjetjes së punës.

Numërimet e frekuencës tregojnë nëse ka ndonjë gabim brenda të dhënave. Për të përcaktuar gabimin, dhe ndoshta korrigjuar atë, është e nevojshme të përcaktohet rasti ku ka ndodhur gabimi. 'Lista' e procedurave bën të mundur ekzaminimin e vlerave të ndryshoreve në raste të veçanta.

8.5. Analiza e mëtejshme statistikore

Numërimi i thjeshtë i frekuencave ('frekuencat'), përshkruesve statistikorë ('përshkruesit') dhe vëllimi i tabelës që përmban një ndarje të rezultateve për grupet e rëndësishme të studimit (si gjinia, fusha e studimit) i japin përgjigje shumicës së pyetjeve të anketës.

- Për pyetje të veçanta, për shembull, është interesante të analizohen përgjigjet duke bërë diferencimin e mëtejshëm të karakteristikave (gjinia, performanca e studimit, origjina, arsimi profesional).

- Për shembull, do të ishte interesante nëse do të shqyrtonim përgjigjet e disa pyetjeve ku në fakt nuk kërkoheshin karakteristikat specifike, por këto të fundit u gjeneruan nga kombinimi i karakteristikave individuale.
- Nëse vërehen dallime në pyetjet kryesore, për shembull sa i takon fushës lëndore/tematike, vitit të diplomimit dhe fushës së punësimit, është e rëndësishme të drejtohen pyetje vetëm për ato që janë më të rëndësishme.

Kjo nuk është e mundur vetëm nëpërmjet krahasimit të vlerave ose mesatares së përqindjeve, por ka nevojë për procedura të veçanta. Meqenëse mund të ekzistojnë edhe lidhje midis fushës lëndore dhe fushës së punësimit, këshillohet përdorimi i strategjive të analizës multivariate (p.sh. procedurat e *SPSS-së Anova* ose *Regression*). Kjo nuk është një analizë e efektivitetit thjesht për të përshkruar dallimet ndërmjet grupeve apo marrëdhëniet midis ndryshoreve. Për të përcaktuar masën në të cilën karriera e mëtejshme profesionale e të diplomuarve ndikohet nga studimet e tyre dhe nga kushtet e studimit, nevojitet një analizë më e hollësishme, përshkrimi i së cilës do të ishte përtej qëllimit të këtij udhëzuesi.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**




swisscontact

KAPITULLI 9. PREZANTIMI I REZULTATEVE

Nëse duam që rezultatet e studimit gjurmues të përdoren sa më gjerësisht, atëherë vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet hartimit të raportit të gjetjeve. Raportet duhet të jenë të hapura dhe të disponueshme për publikun, duke rritur kështu gjasat që gjetjet të përdoren nga një gamë e gjerë aktorësh, siç janë: nxënësit potencialë dhe prindërit e tyre, nxënësit aktualë, mësuesit, drejtuesit e institucioneve të AFP, punëdhënësit, qeveria, komuniteti i donatorëve dhe studiuesit. Vendimet për pasojat praktike të rezultateve duhet të bazohen në një interpretim të plotë të gjetjeve, duke marrë parasysh cilësinë e të dhënave, si dhe interpretime të tjera të mundshme. Analiza e të dhënave mund të ndihmojë për të testuar disa nga interpretimet e mundshme.

9.1. Sfidat kryesore në lidhje me interpretimin

Studimet gjurmuese institucionale zakonisht kanë për qëllim të marrin të dhëna empirike, të cilat mund të përdoren për përmirësime praktike brenda institucionit. Megjithatë, mësimet praktike mund të nxirren vetëm nëse të dhënat kanë cilësinë e duhur. Gjithashtu duhet të publikohet edhe metodologjia, për të krijuar mundësinë për diskutim kritik dhe argumente për përmirësim.

9.1.1. Cilësia e lartë e anketimit është e nevojshme

Problemet kryesore që duhet të adresohen, për të siguruar cilësinë e lartë të studimit, janë si më poshtë:

- Testimi i besueshmërinë dhe vlefshmërisë së të dhënave
- Testimi i përfaqësuesve
- Sigurimi i shkallës së lartë të përgjigjes
- Sigurimi i vlefshmërisë së adresave

Për më tepër, raportet nga studimet gjurmuese duhet të përmbajnë informacion të mjaftueshëm për çështjet kyçe metodologjike si: kampionimi, cilësia e adresave, numri dhe lloji i kontakteve me të diplomuarit, shkalla e përgjigjes dhe përfaqësuesit, cilësia e të dhënave, lloji i manipulimit dhe analizës së të dhënave. Nëse nuk sigurohet ky informacion atëherë cilësia e të dhënave mbetet e dyshimtë.

9.1.2. Sigurimi i informacionit të mjaftueshëm

Ndonjëherë studimet gjurmuese ofrojnë vetëm informacione të thjeshta. Ata përdorin një gamë shumë të vogël të të dhënave "objektive" për statusin e punësimit dhe të ardhurat dhe informacion për llojin e institucionit, nivelin e diplomës, fushën e studimit dhe institucionin përkatës. Nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme që të sigurohet informacion i

mjaftueshëm, i cili është i rëndësishëm për menaxhimin e cilësisë, si gjenerimi dhe përdorimi i njohurive dhe dimensionit i ndikimit të AFP-së.

9.1.3. Interpretimi i munguar ose i gabuar i gjetjeve

Në raportet për studimet gjurmuese mungon shpesh interpretimi i gjetjeve. Raportet shpesh janë vetëm një verbalizim i gjetjeve të përzgjedhura përshkruese të paraqitura në tabela dhe grafikë. Ndonjëherë edhe një tekst i tillë kaq i thjeshtë është çorientues sepse paraqet vetëm gjetjet e përzgjedhura dhe përzgjedhja mund të jetë e njëanshme, si në shembullin e mëposhtëm. Ndonjëherë interpretimi i rezultateve është krejtësisht i gabuar sepse shkruarit e raportit nuk kanë njohuritë e domosdoshme për të bërë interpretime kuptimplota.

Shembull që duhet shmangur

'Diploma e arsimit profesional ishte e rëndësishme për punëdhënësit gjatë punësimit të 39.7% të të diplomuarve. Në rastin e punësimit të 18.4% të diplomuarve, diploma ishte "faktori më i rëndësishëm" dhe për 21.3% të të diplomuarve diploma ishte e një rëndësie dytësore për punëdhënësit në momentin e punësimit.'

Autorët nuk kanë raportuar një përgjigje tjetër të të diplomuarve: 55% e të diplomuarve kanë raportuar se arsimi i tyre profesional ka qenë 'jo i rëndësishëm', një gjetje e gjeneruar vetëm duke analizuar tabelën përkatëse.

9.2. Raporti për metodën

Një pjesë e rëndësishme e raportit të rezultateve është raporti për metodën. Lexuesi duhet të jetë në gjendje të kuptojë proceset dhe rezultatin e aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave, si dhe objektivat dhe pyetësin e studimit gjurmues. Çdo studim gjurmues duhet të ketë një raport për metodën, i cili mbulon aspektet e mëposhtme:

- Historikun e studimit gjurmues
- Përshkrimin e objektivave
- Zhvillimin e instrumenteve / pyetësorëve hulumtues (burimet?)
- Testimin e pyetësorit
- Popullatën e synuar
- Cilësinë dhe sasinë e adresave
- Përditësimin e procedurave për adresat
- Kohën e anketës, rilajmërimet për kujtesë
- Statistikat e përgjigjeve
- Kontrollimin e përfaqësuesve (krahasimi me statistikën ekzistuese)
- Procedurat e analizës së të dhënave (programi kompjuterik/softueri dhe procedurat e përdorura)
- Reflektimin kritik në lidhje me cilësinë e të dhënave (besueshmëria dhe vlefshmëria)



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ajencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC




swisscontact

9.3. Raporti mbi rezultatet

Rezultatet janë vendimtare për efektivitetin e një ankete, por jo vetëm. Edhe mënyra e paraqitjes së këtyre rezultateve është po aq e rëndësishme. Shumë studime gjurmuese me kosto të lartë nuk arritën të kishin efektivitet të madh, sepse iu kushtua shumë pak vëmendje raportimit. Rekomandohet fuqimisht publikimi i raportit. Përgatitja e një raporti, i cili do të publikohet në internet, është një proces më i kushtueshëm dhe merr më shumë kohë sesa përgatitja e një dokumenti të brendshëm pune, por kjo punë shtesë ia vlen.

Të diplomuarve që morën pjesë në studimin gjurmues duhet t'u sigurohet një raport i shkurtër në lidhje me studimin. Kjo mund të jetë një nxitje edhe për të marrë pjesë në anketë. Raporte të tilla (ndoshta të vëna në dispozicion në faqen e internetit të studimit gjurmues) mund të motivojnë edhe nxënësit aktualë për të marrë pjesë kur të diplomohen. Raportet e publikuara tregojnë përdorimin e rezultateve nga institucioni dhe mund të jenë një aspekt kyç në krijimin e kulturës së vetëvlerësimit.

Përderisa nuk është e mundur që të standardizohet hartimi i raportit në lidhje me anketën, më poshtë gjeni disa rekomandime të përgjithshme.

- Kini parasysh që disa nga lexuesit (publiku, punëdhënësit, nxënësit e mëvonshëm dhe prindërit e tyre) mund të kenë pak ose aspak njohuri për programin dhe institucionin e AFP-së. Prandaj, shmangni përdorimin e shkurtesave, të cilat mund të mos jenë të njohura për të gjithë.
- Çdo kapitull në raport ka nevojë për një hyrje të shkurtër për temën / pyetjet e drejtuara:
 - Çfarë doni të dini;
 - Pse doni ta dini: shpjegoni qëllimin praktik;
 - Konteksti teorik.
- Sa i takon paraqitjes të gjetjeve të përzgjedhura:
 - **Përdorni përqindjet** - Shumicën e kohës, 'rezultati' është një përshkrues statistikor, prandaj rekomandohet që të përdoren përqindjet, pasi ato mund të kuptohen më mirë nga lexuesit. Nga ana tjetër, mjetet aritmetike janë të kuptueshme vetëm kur shpjegohet shkalla.
 - **Jini të saktë** - Shmangni përdorimin e termave të pacaktuar si shumë, ca, pak, disa (kur i referoheni të diplomuarve), nëse informacioni i saktë nuk është paraqitur edhe në formën e përshkrimeve statistikore në të njëjtën kohë. Përdorimi i "shumë të diplomuar (82%) ..." është i pranueshëm pasi termi 'shumë' është sqaruar në kllapa.
 - **Paraqisni rezultatet e plota në tabela dhe / ose grafika** - Gjetjet kryesore duhet të paraqiten edhe në formën e një table ose grafiku (pranë informacionit në tekst). Shumica e tabelave dhe grafikëve përmbajnë shumë më tepër informacione sesa mund të përmbajë një tekst, dhe duke i studiuar

ato lexuesi është në gjendje të kontrollojë paraqitjen e rezultateve, si dhe të nxjerrë në pah detaje shtesë për pyetjen dhe përgjigjet. Tabelat dhe grafikët duhet të përmbajnë gjithmonë informacionin e plotë rreth formulimit të pyetjeve dhe përgjigjeve, duke përfshirë shkallën në të cilën bazohen.

- **Paraqisni rezultatet e përgjithshme të parat dhe pastaj rezultatet e grupit** - Lexuesit mund ta kuptojnë prezantimin shumë më lehtë nëse më parë paraqiten rezultatet për popullsinë e përgjithshme dhe më pas - aty ku është me interes - bëhet dallimi i gjetjeve.
- **Numri i pikëve dhjetore** - Zakonisht nuk rekomandohet që të përdoren përqindjet me pikë dhjetore (gabim: 11.3%, korrekte: 11%). Në rastin e mesatares aritmetike (*mean ose median*), një pikë dhjetore është e mjaftueshme.

9.4. Raportet e tabelave

Një mjet shumë i dobishëm për paraqitjen e rezultateve të një studimi gjurmues është raporti i plotë pwr tabelat. Një raport i tillë përfshin të gjitha përgjigjet e të gjitha pyetjeve, me një ndarje të mëtejshme të grupeve kryesore. Raporti i tabelave përfshin të gjitha pyetjet e pyetësorit sipas renditjes origjinale. Një raport i tillë e bën të lehtë përzgjedhjen e gjetjeve interesante (tabelat) dhe shkrimin e komenteve dhe interpretimeve. Këto lloj raportesh duhet të përgatiten për ndryshoret e thyera (*break variable*) (si programi i studimit, gjinia, sektori ekonomik, etj.) që lidhen me objektivat e studimit gjurmues.

Propozimet për ndryshoret e thyera përfshijnë:

- Fushën e studimit ose të programit studimor
- Llojin e diplomës / kualifikimit
- Kombinimin e fushës së studimit dhe gjinisë
- Statusin e punësimit
- Sektorin ekonomik

9.5. Interpretimi i rezultateve dhe konkluzioneve praktike

Konkluzionet praktike nga rezultatet e studimit gjurmues mund të nxirren vetëm nëse kryhet një interpretim i thellë i rezultateve. Interpretimi i rezultateve kërkon:

- Reflektimin kritik mbi mundësinë e rezultateve të njëanshme
- Krahasimin e rezultateve nga pyetjet e ngjashme në studimin gjurmues
- Marrjen parasysh të informacionit në lidhje me kontekstin arsimor, të përfutur jo përmes studimit (siç është informacioni për institucionin dhe programin e studimit / kursin e formimit)
- Marrjen parasysh të informacionit në lidhje me tregun e punës, të përfutur jo përmes studimit (siç është informacioni për papunësinë, ciklin ekonomik, strukturën ekonomike në rajon).

Prandaj, detyra e interpretimit është gjithnjë e kombinuar me analizën e të dhënave.

Krahasueshmëria

Një aspekt i rëndësishëm i interpretimit të rezultateve është krahasueshmëria me gjetjet nga studimet e tjera gjurmuese në të njëjtin institucion, të cilat janë bërë më herët ose me studimet gjurmuese nga institucionet e tjera. Gjëja më e rëndësishme që duhet të kryhet brenda një institucioni, është krahasimi i programeve studimore. Nëse objektivi i këtij aktiviteti është dalja në përfundime në lidhje me këtë nivel, atëherë të gjitha rezultatet e studimit duhet të paraqiten në nivel programi studimi / kursi formimi. Rezultatet e përgjithshme për të gjithë institucionin janë më pak interesante në këtë kontekst, por marrëdhëniet në kuadër të të dhënave të mbledhura janë të rëndësishme dhe duhet të kontrollohen dhe të krahasohen në mënyrë sistematike.

Metodat e përshtatshme statistikore

Përdorimi i metodave të përshtatshme statistikore është vendimtar edhe për interpretimin e rezultateve, përpara se të nxirren konkluzione për vendimet në nivel politikash. Rezultatet prodhohen gjithmonë nga një metodë e përzgjedhur statistikore: nuk ekziston asnjë mënyrë e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë që të çon nga të dhënat tek rezultatet. Për shembull, reduktimi i analizës statistikore në atë mënyrë që të bëhet e mundur vetëm paraqitja e frekuencave të thjeshta për të gjithë popullsinë (si të gjithë të diplomuarit nga një institucion) është çorientues, sepse mund të ketë dallime të mëdha në mes të aspekteve siç janë programet e studimit / kurset e formimit dhe gjinia. Masa e ekzistencës së këtyre dallimeve dhe mënyra e shpjegimit të 'rezultateve të punësimit' nga ana e tyre duhet të testohen me metoda statistikore të përshtatshme, të tilla si kros-tabulimi, analiza e variancës dhe analiza e regresionit. Domethënia statistikore dhe rëndësia e gjetjeve, interpretimi i rezultateve zakonisht duhet të bazohen në 'domethënie statistikore', por kjo nuk është identike me 'rëndësinë'. Domethënia statistikore ndihmon në shmangien e mbi-interpretimit të gjetjeve, të cilat mund të kenë ndodhur rastësisht. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse numri i rasteve është i vogël.

Rezultatet e njëanshme

Në interpretimin e rezultateve duhet gjithmonë të diskutohet nëse rezultatet mund të jenë të njëanshme, dmth. që ato mund të influencohen në një drejtim të caktuar dhe jo vetëm nga një gabim i rastësishëm. Për të zbuluar rezultatet e njëanshme, raporti për metodën duhet të përmbajë informacion të saktë dhe të plotë rreth procedurave të anketimit. Meqenëse është pothuajse e pamundur të korrigjohen rezultatet e njëanshme, është shumë e rëndësishme për të gjithë studimin që të bëhen përpjekjet e duhura për të siguruar që kampioni i të diplomuarve pjesëmarrës të jetë sa më përfaqësues. Nëse njëanshmëria nuk mund të shmanget, atëherë kjo duhet të bëhet e qartë në raport si një informacion kyç për diskutimin kuptimplotë të rezultateve.

- **Njëanshmëria në përzgjedhje** - Nëse kampioni i të diplomuarve që marrin pjesë në studimin gjurmues nuk është përfaqësues i popullsisë së përgjithshme, rezultati mund të jetë çorientues. Për shembull, kontaktimi vetëm i të diplomuarve që janë anëtarë të shoqatës së ish-nxënësve të institucionit mund ta anojë modelin drejt të diplomuarve të suksesshëm.
- **Konfuzuese** - Nëse përfundimet do të nxirren nga rezultatet, atëherë është e nevojshme që të gjithë faktorët e mundshëm kontribues të diskutohen me kujdes. Për shembull, rezultatet e një studimi gjurmues flasin për një nivel të lartë të 'mospërputhjes' të aftësive të fituara gjatë studimit / formimit dhe detyrave që duhet të kryejnë në punë. Çfarë do të thotë kjo? A mund të dalim me përfundimin që duhet të ndryshojmë kurrikulën apo të mbyllim programin e studimit / formimit? Përfundime të tilla nuk marrin parasysh shumë faktorë përveç arsimimit / formimit që mund të shpjegojë rezultatin.

Disa prej tyre mund të adresohen direkt në pyetësor, si për shembull:

- Kjo punë është vetëm një trampolinë e përkohshme
- Paga më e lartë në punën aktuale
- Ky vend pune ofron më shumë siguri
- Interesat kanë ndryshuar

Cila ishte arsyeja kryesore pse u largove nga puna jote e fundit?

- Më mbaroi periudha e provës
 - Më mbaroi kontrata e punës
 - Vendi i punës/pozicioni që kisha nuk përputhej me arsimimin tim
 - Kishte shkurtime në vendin e punës
 - Për arsye personale
 - Tjetër (të lutem specifiko): _____
-

Motivimi individual, përputhja vertikale dhe tregu i punës në një kohë të caktuar dhe në një rajon të caktuar janë të gjithë faktorë të rëndësishëm, të cilët duhet të merren parasysh para se të nxirren konkluzione. Interpretimet synojnë të shpjegojnë gjetjet ose të paktën t'i klasifikojnë ato brenda një kuadri shpjegimi. Shpesh këto interpretime fillojnë me fjalinë e mëposhtme: 'Duhet të merret parasysh se ...'. Në anketat shkencore, të cilat përdoren për të testuar hipoteza specifike, teoria që duhet të analizohet përfaqëson kornizën e shpjegimit dhe interpretimit. Nga ana tjetër, anketat e të diplomuarve zbatohen rrallë për të testuar hipoteza individuale të krahasueshme; përkundrazi, ato ofrojnë një mori informacioni, i cili është i dobishëm për qëllime të ndryshme.

Prandaj, gjatë prezantimit të rezultateve dhe interpretimit të tyre është e rëndësishme që të zhvillohet një kuadër interpretimi i cili klasifikon gjetjet e veçanta. Kjo është e mundur duke zgjedhur standarde relative të krahasimit për interpretimin.

Shembull

Pyetja. Në ç'shallë mendon se duhet të përmirësohen aspektet e mëposhtme në shkollë për t'i përgatitur më mirë të diplomuarit për tregun e punës?

Analiza mund të interpretohet duke u krahasuar me: (a) drejtimin; (b) gjininë; (c) statusin e punësimit.


Ndryshimi me kalimin e kohës

Nëse studimet gjurmuese bëhen çdo vit, krahasimi me rezultatet e studimeve nga vitet e ndryshme do të çojë në një mundësi interesante për interpretim. Aty ku janë zbatuar masat për përmirësimin e kushteve dhe ofertës së studimit (si kurrikuli), studimet e rregullta gjurmuese mund të ndihmojnë për të kuptuar nëse këto përmirësime kanë ndikuar tek kompetencat e të diplomuarve dhe në punësueshmërinë e tyre. Rezultatet e studimeve të mëparshme gjurmuese mund të përdoren më pas si bazë për krahasimin, edhe pse duhet të merren parasysh edhe faktorët e tjerë kontekstualë (p.sh. tregu i punës).

9.6. Keqinterpretimi i rezultateve

Gjetjet për suksesin profesional të të diplomuarve nuk mund të konsiderohen si rezultat i drejtpërdrejtë i studimit / formimit, prandaj përfundimet për përmirësime nuk mund të bazohen tek gjetjet pa marrë parasysh faktorët përkatës kontekstualë. Për shembull, niveli i ulët i punësimit të të diplomuarve mund të jetë rezultat i motivimit të shumë të diplomuarve për të vazhduar studimet për të arritur një nivel më të lartë arsimor ose për të ndryshuar fushën e formimit profesional. Në përgjithësi është e gabuar të merren rezultatet e studimeve gjurmuese si tregues të thjeshtë të performancës, të cilat mund të lidhen drejtpërdrejt me veprimet e politikave. Duhet të merren parasysh shumë tregues të suksesit profesional (si statusi i punësimit, të ardhurat, lidhjet vertikale dhe horizontale me studimin / formimin, kënaqshmëria në punë), dhe veçanërisht kushtet e tregut të punës në sektorë dhe rajone të ndryshme.

Meqenëse punësueshmëria e të diplomuarve mund të varet nga shumë faktorë, të cilët nuk janë të formësuar nga programi i studimit, pasojat praktike të rezultateve të studimeve gjurmuese shpesh nuk janë të qarta. Rezultatet - nëse analizohen me kujdes - mund të japin disa ide në lidhje me pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit, por vendimmarrësit në sektorin e arsimit nuk mund t'i bazojnë strategjitë e tyre të ndryshimit thjesht në këto gjetje. Edhe vlerësimi retrospektiv i programit të studimit nga të diplomuarit mund të jetë i njëanshëm, në varësi të përvojave të ndryshme në tregun e punës. Për shembull, nëse një brez të diplomuarish përballet papritmas me probleme serioze sa i takon sigurimit të punësimit të duhur për shkak të krizës ekonomike, vlerësimet retrospektive të kushteve dhe ofertave të studimit mund të ndikohen negativisht më shumë për shkak të përvojës së tyre në tregun e varfër të punës sesa nga kushtet dhe oferta e studimit.



Ajencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



9.7. Aktivitetet ndërgjegjëse

Rezultatet e studimeve gjurmuese institucionale duhet të shpërndahen për të gjitha palët e interesuara të identifikuar në objektivat e studimit:

- Nxënësit dhe prindërit e tyre
- Të diplomuarit
- Stafi i institucionit arsimor
- Vendimmarrësit në nivele të ndryshme të sistemit
- Këshilluesit e nxënësve
- Këshilluesit e karrierës
- Punëdhënësit
- Studiuesit në fushën e arsimit
- Mjetet e komunikimit masiv

Disa aktivitete të tjera ndërgjegjëse janë:

- Njëpërmjet ish-nxënësve
 - Gjatë ceremonisë së diplomimit
 - Përgatitja e promovimit në media (video)
- Njëpërmjet botimit
 - Faqja e internetit të ish-nxënësve
 - Faqja e internetit të shkollave të AFP
- Nxënësit
 - Programi për orientimin e të nxënit
 - Seminaret profesionale të nxënësve



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË


swisscontact

KAPITULLI 10. VETË-VLERËSIMI I CILËSISË SË STUDIMIT

Ky kapitull prezanton një mënyrë të lehtë për të kontrolluar cilësinë e metodologjisë së një studimi gjurmues. Ai është organizuar si një pyetësor dhe mund të përdoret në çdo fazë të studimit për të vlerësuar se çfarë është planifikuar apo çfarë është bërë. Kriteret vijuese për cilësinë e studimit gjurmues janë marrë nga hapat e ndryshëm në kryerjen e një studimi gjurmues të përshkruar në këtë udhëzues:

- Objektivat e studimit
- Baza e të dhënave për adresat
- Cilësia e pyetësorit
- Procedurat e anketimit
- Analiza e të dhënave
- Cilësia e raportimit
- Aktivitetet ndërgjegjëse

10.1. Objektivat e studimit gjurmues

P1 – Deri në çfarë bini dakord me fjalitë e mëposhtme lidhur me objektivat e studimit gjurmues? Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1=aspak dhe 5=jashtëzakonisht shumë

Objektivat janë shumë të qarta	1	2	3	4	5
Zgjedhja e popullsisë së synuar lidhet me objektivat	1	2	3	4	5
Objektivat janë të lidhura qartë me literaturën kërkimore	1	2	3	4	5
Objektivat janë shumë të detajuara	1	2	3	4	5
Konkluzionet e studimit gjurmues lidhen me objektivat	1	2	3	4	5
Në përgjithësi: objektivat e studimit gjurmues janë të një cilësie të lartë	1	2	3	4	5

10.2. Baza e të dhënave për adresat

P2 – Si e vlerësoni cilësinë e bazës së të dhënave të studimit gjurmues për adresat? Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1=aspak dhe 5=jashtëzakonisht shumë

Plotësia e adresave në lidhje me popullatën e synuar	1	2	3	4	5
Informacioni në lidhje me statusin e përditësimit të adresave	1	2	3	4	5
Informacioni për të gjitha aktivitetet e përditësimit	1	2	3	4	5
Informacioni rreth procesit të fazës në terren	1	2	3	4	5
Baza e të dhënave për adresat në përgjithësi	1	2	3	4	5

10.3. Cilësia e pyetësorit

P3 – Si i vlerësoni aspektet e mëposhtme të pyetësorit të studimit gjurmues? Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1=aspak dhe 5=jashtëzakonisht shumë

Procesi i testimit të pyetësorit	1	2	3	4	5
Formati i pyetësorit	1	2	3	4	5
Gjatësia e pyetësorit	1	2	3	4	5
Cilësia e pyetësorit në përgjithësi	1	2	3	4	5

10.4. Procedurat e anketës

P4 - Si i vlerësoni procedurat e studimit gjurmues? Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1=aspak dhe 5=jashtëzakonisht shumë

Kampionimi (përzgjedhja e popullatës së synuar të anketës)	1	2	3	4	5
Shkalla e përgjigjes është arritur	1	2	3	4	5
Dokumentimi i aktiviteteve për të kontaktuar të diplomuarit	1	2	3	4	5
Pilotimi	1	2	3	4	5
Procedurat e anketimit në përgjithësi	1	2	3	4	5

10.5. Analiza e të dhënave

Si e vlerësoni analizën e të dhënave të studimit gjurmues? Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1=aspak dhe 5=jashtëzakonisht shumë

Analiza përshkruese e të gjithë popullsisë	1	2	3	4	5
Krahasimi përshkrues i grupeve (tabelat)	1	2	3	4	5
Analiza statistikore e dallimeve ndërmjet grupeve (analiza e variancës)	1	2	3	4	5
Analiza multivariate (si analiza e regresionit)	1	2	3	4	5
Analiza e të dhënave në përgjithësi	1	2	3	4	5

10.6. Cilësia e raportit

P6 - Si i vlerësoni raportet e studimit gjurmues? Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1=aspak dhe 5=jashtëzakonisht shumë

Prezantimet (p.sh. Powerpoint)	1	2	3	4	5
Rekomandimet në lidhje me të dhënat / rezultatet	1	2	3	4	5
Raportimi në përgjithësi	1	2	3	4	5

10.7. Aktivitetet ndërgjegjëse

P7 - Si i vlerësoni aktivitetet ndërgjegjëse? Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1=aspak dhe 5=jashtëzakonisht shumë

Informacioni / raportet për drejtuesit e institucionit	1	2	3	4	5
Informacioni / raportet për stafin e institucionit të AFP	1	2	3	4	5
Përdorimi i rezultateve për përmirësimin e kurrikulës	1	2	3	4	5
Përdorimi i rezultateve për përmirësimin e kushteve dhe ofertës të studimit e AFP	1	2	3	4	5
Aktivitetet ndërgjegjëse në përgjithësi	1	2	3	4	5

Aneks 1. Model pyetësor gjurmimi

EMRI I INSTITUCIONIT OFRUES TË AFP-SË

[vendos logon e institucionit]

ANKETA PËR TË DIPLOMUARIT E [vendos kohortin]

[vendos muajin, vitin e anketimit]

Të ftojme të marrësh pjesë në këtë anketë që zhvillohet për të diplomuarit që kanë përfunduar me sukses studimet në [vendos emrin e institucionit] në vitin [vendos vitin].

Ne do të donim të dinim se si ke ecur qëkur ke përfunduar studimet. A ke gjetur punë apo je akoma duke kërkuar për punë? A i përdor njohuritë dhe aftësitë që ke fituar gjatë studimeve në punën tënde të përditshme? Përgjigjet e tua do të përdoren për qëllime studimore dhe kanë shumë rëndësi për të vlerësuar punësueshmërinë e të diplomuarve për të përmirësuar kështu programet mësimore të ofruara në [vendos emrin e institucionit]. Qëllimi ynë përfundimtar është të përmirësojmë mjedisin e arsimit dhe formimit profesional për nxënësit e ardhshëm për të garantuar që të diplomuarit tonë të sigurojnë një punë të denjë dhe/ose të kenë akses në studime të mëtejshme.

Pyetësi do të të marrë vetëm 5-10 minuta të kohës tënde për t'u plotësuar në varësi të seksioneve ku do të drejtohesh ndërsa e plotëson.

Ki parasysh se informacioni që do të ndash do të trajtohet në mënyrë rreptësisht konfidenciale dhe rezultatet në vijim do të publikohen në një mënyrë të atillë që identifikimi individual mbetet i pamundur.

Ke ndonjë pyetje? Mund të kontaktosh [vendos personin e kontaktit] tek [vendos korrespondencën e personit të kontaktit].

Faleminderit për bashkëpunimin!

/Ylli tregon pyetjet të cilat janë të detyrueshme (*)

SEKSIONI I: PËRFSHIRJA NË TREGUN E PUNËS

/PYETJE ME FILTER

Pyetja 1. Cila është situata jote aktuale e punësimit? (*) *Zgjidh vetëm një alternativë*

- a. I/E punësuar
- b. I/E vetë-punësuar
- c. Pa punë
- d. Student/Kursant
- e. Tjetër (të lutem specifikoj): _____

/Kur alternativa **I/E PUNËSUAR** zgjidhet vijon seria e mëposhtme e pyetjeve:

Pyetja 2. Kur e ke filluar punën tënde të parë? (*)

- a. Para diplomimit
- c. 1 muaj pas diplomimit
- d. 1 - 3 muaj pas diplomimit
- e. 3 - 6 muaj pas diplomimit
- f. 6 - 9 muaj pas diplomimit
- g. 9 - 12 muaj pas diplomimit

Pyetja 3. Si e gjeje punën tënde të parë? (*)

- a. Nëpërmjet shpalljeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë etj
- b. Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve
- c. Nëpërmjet praktikës profesionale në biznes
- d. Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (p.sh. duke dërguar CV etj.)
- e. Nëpërmjet qendrës së karrierës/njesisë së zhvillimit në shkollë
- f. Nëpërmjet mësuesve
- g. Nëpërmjet Zyrës së Punësimit
- h. Tjetër (të lutem specifikoj): _____

/PYETJE ME FILTER

Pyetja 4. Sa punë ke ndërruar që nga diplomimi? (*)

- a. Asnjë (jam në të njëjtën punë)
- b. 1
- c. 2
- d. Tjetër _____

/Kur alternativat **1** ose **2** ose **Tjetër** zgjidhen vijon seria e mëposhtme e pyetjeve:

Pyetja 4a. Cila ishte arsyeja kryesore që u largove nga puna jote e fundit? (*)

- a. Më mbaroi kontrata e punës
- b. Vendi i punës nuk përputhej me arsimimin tim
- c. M'u ofrua një pagë më e mirë tek puna e re
- d. M'u ofruan kushte më të mira pune tek puna e re
- e. Kishte shkurtime në vendin e punës
- f. Për arsye personale
- g. Tjetër (të lutem specifikoj): _____

Pyetja 4b. Sa kohë ke që punon te puna aktuale? (*)

- a. Më pak se 1 muaj
- b. 1 -3 muaj
- c. 3 - 6 muaj
- d. 6 - 9 muaj
- e. Tjetër (të lutem specifik): _____

Kur alternativa **Asnjë** zgjidhet vijon seria e mëposhtme e pyetjeve:

Pyetja5. Sa është numri i punonjësve në kompaninë ku punon (në total, jo vetëm në vendin tënd të punës)? *Jep një vlerësim të përafërt* (*)

- a. 1-4 punonjës
- b. 5-9 punonjës
- c. 10-49 punonjës
- d. >50 punonjës

Pyetja 6. Cila është puna/profesia që bën? (p.sh. Kamariere, Elektriciere, Mekanik, Ndihmëse/ Kuzhinere, Ndihmëse ekonomiste) (*)

Të lutem specifik _____

Pyetja 7. A lidhet puna që bën me fushën tënde të arsimit? (*)

- a. Po
- b. Jo

Pyetja 7a. Nëse jo, pse? (*)

- a. Nuk gjeja një vend pune që lidhet me studimet e mia
- b. Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia
- c. Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon
- d. Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira
- e. Tjetër (të lutem specifik): _____

Pyetja 8. A punon me kohë të plotë? (*)

- a. Po, punoj me kohë të plotë
- b. Jo, punoj me kohë të pjesshme
- c. Punoj me kohë të plotë, por sezonale

Pyetja 9. Çfarë lloj kontrate pune ke me punëdhënësin? (*)

- a. Kontratë të përkohëshme
- b. Kontratë të përhershme
- c. Po bëj praktikë
- d. Jam pa kontratë

Pyetja 10. A të paguhen sigurimet? (*)

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk e di

Pyetja 11. Sa janë të ardhurat e tua mujore nga puna (lek të reja, neto - dmth duke hequr taksat dhe kontributet) ? (*)

- a. Më pak se 23,000 LEK
- b. 23,001 – 35,000 LEK
- c. 35,001 – 50,000 LEK
- d. 50,001 – 65,000 LEK
- e. 65,001 – 80,000 LEK
- f. Më shumë se 80,001 LEK

Pyetja 12. Sa i/e sigurt (i stabilizuar) ndihesh në punën tënde aktuale?

- a. Shumë i/e pasigurt
- b. I/e pasigurt
- c. As i sigurt as i pasigurt/ neutral
- d. I/e sigurt
- e. Shumë i/e sigurt

Pyetja 13. Sa i/e kënaqur je me vendin tënd të punës?

- a. Shumë i/e pakënaqur
- b. I/e pakënaqur
- c. As i kënaqur as i pakënaqur/ neutral
- c. I/e kënaqur
- d. Shumë i/e kënaqur

/Kur alternativa **I/E VETË-PUNËSUAR** zgjidhet vijon seria e mëposhtme e pyetjeve:

Pyetja 2. A lidhet fusha e aktivitetit tënd të vetë-punësimit me arsimin që ke marrë? (*)

- a. Po
- b. Jo

Pyetja 2a. Nëse jo, pse? (*)

- a. Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia
- b. Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia
- c. Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon
- d. Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira
- e. Tjetër (të lutem specifiko): _____

Pyetja 3. Sa kohë pas diplomimit t'u desh që të hapje biznesin tënd? (*)

- a. Është biznesi i familjes
- b. E kam hapur para diplomimit
- c. 1 muaj pas diplomimit
- d. 1 -3 muaj pas diplomimit
- e. 3 - 6 muaj pas diplomimit
- f. 6 - 9 muaj pas diplomimit
- g. 9 - 12 muaj pas diplomimit

Pyetja 4. Përveç vetes tënde, sa të punësuar të tjerë ke? (*)

- a. Asnjë
- b. 1
- c. 2
- d. 3
- e. Tjetër _____

Pyetja 5. Sa janë të ardhurat e tua mujore lek të reja *neto* nga vetë-punësimi? (*)

- a. Më pak se 23,000 LEK
- b. 23,001 – 35,000 LEK
- c. 35,001 – 50,000 LEK
- d. 50,001 – 65,000 LEK
- e. 65,001 – 80,000 LEK
- f. Më shumë se 80,001 LEK

Pyetja 6. Si e shikon perspektivën e vetë-punësimit? (*)

- a. E shoh si një aktivitet të përhershëm timin
- b. E shoh si një aktivitet të përkohshëm deri në një punësim më të sigurtë në një kompani
- c. Nuk e di
- d. Tjetër (të lutem specifik): _____

Pyetja 7. Sa i/e kënaqur je me punën tënde?

- a. Shumë i/e pakënaqur
- b. I/e pakënaqur
- c. As i pakënaqur as i kënaqur / neutral
- d. I/e kënaqur
- e. Shumë i/e kënaqur

/Kur alternativa **PA PUNË** zgjidhet vijon seria e mëposhtme e pyetjeve:

Pyetja 3. Cila mendon se është arsyeja kryesore se pse je pa punë? (*)

- a. Më mungon eksperiencia e punës
- b. Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës
- d. Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim
- e. Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë
- g. Nuk ka punë në qarkun tim
- i. Jam i/e angazhuar në punë familjare (me rritjen e fëmijëve/punët e shtëpisë)
- j. Tjetër (të lutem specifik): _____

/ PYETJE ME FILTER

Pyetja 4. A ke qenë ndonjëherë i punësuar që nga koha e diplomimit? (*)

- a. Po
- b. Jo

/Kur alternativa **PO** zgjidhet vijon seria e mëposhtme e pyetjeve:

Pyetja 4a. Kur e ke filluar punën tënde të parë pas diplomimit? (*)

- a. Kam filluar punë që para diplomimit
- c. 1 muaj pas diplomimit
- d. 1 - 3 muaj pas diplomimit
- e. 3 - 6 muaj pas diplomimit
- f. 6 - 9 muaj pas diplomimit
- g. 9 - 12 muaj pas diplomimit

Pyetja 4b. Si e gjete punën tënde të parë? (*)

- a. Nëpërmjet shpalljeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë etj

- b. Njëpërmjet njohjeve familjare, miqve, të njohurve
- c. Njëpërmjet praktikës profesionale në biznes
- d. Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)
- e. Njëpërmjet qendrës së karrierës/njesisë së zhvillimit në shkollë
- f. Njëpërmjet mësuesve
- g. Njëpërmjet Zyrës së Punësimit
- h. Tjetër (të lutem specifikoj): _____

Pyetja 4c. Cila ishte arsyeja kryesore pse u largove nga puna jote e fundit? (*)

- a. Më mbaroi periudha e provës
- b. Më mbaroi kontrata e punës
- c. Vendi i punës/pozicioni që kisha nuk përputhej me arsimimin tim
- d. Kishte shkurtime në vendin e punës
- e. Për arsye personale
- f. Tjetër (të lutem specifikoj): _____

/Kur alternativa **JO** zgjidhet vijon seria e mëposhtme e pyetjeve:

Pyetja 5. A ke kërkuar për punë në këto 4 javët e fundit? (*)

- a. Po
- b. Jo
 - Nëse jo, pse?
 - a. Jam duke studiuar
 - b. Po pres për sezonin e përshtatshëm
 - c. Po pres të filloj punë së shpejti
 - d. Nuk kam besim se do gjej një punë
 - e. Nuk kam dëshirë të punoj për momentin
 - f. Kam në plan të largohem nga vendi
 - g. Kujdesem për fëmijët/familjen
 - h. Jam me aftësi ndryshe

/Kur alternativa **STUDENT/KURSANT** zgjidhet vijon seria e mëposhtme e pyetjeve:

Pyetja 2. Për çfarë kualifikimi po studion? (*)

- a. Universitet
- b. Shkollë profesionale pas të mesmes
- c. Kurs profesional
- d. Tjetër (të lutem specifikoj): _____

Pyetja 3. A po studion/trajnohesh me kohë të plotë? (*)

- a. Po
- b. Jo (me kohë të pjesshme)

Pyetja 4. Cila është arsyeja kryesore pse po ndjek këto studime/trajnim? (*)

- a. Për të fituar një kualifikim më të lartë
- b. Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë
- c. Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale
- d. Nuk po gjeja dot punë
- e. Tjetër (të lutem specifikoj): _____

/Kur alternativa **TJETËR** zgjidhet vijon seria e mëposhtme e pyetjeve:

Pyetja 2. Me çfarë po merresh për momentin? (*)

- a. Nuk e kam vendosur akoma se çfarë dua të bëj
- b. S'kam qenë në gjendje të gjej punë dhe kam hequr dorë për momentin
- c. Po planifikoj të largohem nga Shqipëria
- d. Po planifikoj të largohem drejt një qyteti tjetër
- e. Jam me aftësi të kufizuar
- f. Jam i/e angazhuar me rritjen e fëmijëve/punë në shtëpi
- g. Tjetër (të lutem specifikoj): _____

SEKSIONI II: LIDHJA MIDIS ARSIMIT DHE PUNËS AKTUALE

/Kur alternativat **I/E VETË-PUNËSUAR** ose **I/E PUNËSUAR** zgjidhen vijon seria e mëposhtme e pyetjeve të Seksionit II:

Pyetja 1. Si të ka ndihmuar shkolla për të gjetur punën tënde të parë pas diplomimit? (*)

- a) Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë
- b) Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit
- c) Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë
- d) Tjetër (të lutem specifikoj): _____
- e) Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar

Pyetja 2. Të lutem përgjigju pyetjeve të mëposhtme duke përdorur një shkallë nga 1 në 5, ku 1=aspak dhe 5=jashtëzakonisht shumë. (*)

a. Në ç'shikullë i përdor njohuritë që ke fituar gjatë studimeve të tua në punën tënde aktuale?	1	2	3	4	5
b. Në ç'shikullë është pozicioni jot aktual i lidhur me studimet e tua?	1	2	3	4	5

Pyetja 3. Në ç'shikullë mendon se duhet të përmirësohen aspektet e mëposhtme në shkollë për t'i përgatitur më mirë të diplomuarit për tregun e punës? Vlerëso në një shkallë nga 1 në 5, ku 1=aspak dhe 5=jashtëzakonisht shumë (*)

a. Infrastruktura	1	2	3	4	5
b. Kurrikulat	1	2	3	4	5
c. Tekset dhe materialet për të mësuar	1	2	3	4	5
d. Metodat e mësimdhënies	1	2	3	4	5
e. Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	1	2	3	4	5
f. Praktika në shkollë	1	2	3	4	5
g. Praktika në biznes	1	2	3	4	5
h. Këshillimi i karrierës	1	2	3	4	5
i. Bashkëpunimi me bizneset	1	2	3	4	5
j. Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	1	2	3	4	5

/Kur alternativat **PA PUNËSUAR** ose **STUDENT/KURSANT** zgjidhen vijon seria e mëposhtme e pyetjeve të Seksionit II:

Pyetja 1. Nëse do të kishe mundësi të zgjidhje përsëri, a do të zgjidhje të njëjtën degë studimi? (*)

- a) Po
- b) Jo

Pyetja 2. Nëse do të kishe mundësi të zgjidhje përsëri, a do të zgjidhje të njëjtën shkollë?

- a) Po
- b) Jo

Pyetja 3. Brenda dy viteve të ardhshme, çfarë dëshiron të kesh arritur? [Më shumë se një alternativë e mundshme] (*)

- a) Të jem punësuar
- b) Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit/trajnimit
- c) Të kem filluar biznesin tim
- d) Të kem ndjekur studime të mëtejshme
- e) Të kem emigruar jashtë vendit
- f) Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit
- g) Tjetër (të lutem specifiko): _____

SEKSIONI III: TË DHËNAT SOCIO-DEMOGRAFIKE

Pyetja 1. (*)

- a. Drejtimi mësimor që ke përfunduar: _____
- b. Profili: _____

Pyetja 2. Emri Mbiemri (*)

- a. _____

Pyetja 3. Gjinia (*)

- a. Mashkull
- b. Femër

Pyetja 4. A i përket ndonjë minoriteti (psh. rom ose egjiptian)?

- a. Po (të lutem specifiko): _____
- b. Jo

Pyetja 5. Ku banon? (*)

/Ylli tregon pyetjet e detyrueshme (*)



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC




swisscontact



Aftësi për punë S4J



@skills_for_jobs



www.skillsforjobs.al